



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 111

Tiranë – E mërkurë, 14 korrik 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 75/2021, datë 14.6.2021	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 21, datë 19.5.2021, “Për miratimin e tekstit të marrëveshjes së furnizimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin e Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar ‘Keymen Ilaç Sanayi ve Ticaret A.S.’” 10173
Ligj nr. 76/2021, datë 14.6.2021	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 22, datë 21.5.2021, “Për miratimin e marrëveshjes së nënshkruar të furnizimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin e Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar ‘Keymen Ilaç Sanayi ve Ticaret A.S.’” 10173
Ligj nr. 77/2021, datë 14.6.2021	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 23, datë 26.5.2021, “Për disa ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, ‘Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19’, të ndryshuar” 10174
Vendim i Kuvendit nr. 61/2021, datë 1.7.2021	Për emërimin anëtar të Këshillit të Statistikave..... 10174
Vendim i Kuvendit nr. 62/2021, datë 7.7.2021	Për përzgjedhjen e kandidatëve, për anëtarë zëvendësues, për pozicionet komisioner të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisioner Publik..... 10174
Vendim i Kuvendit nr. 63/2021, datë 7.7.2021	Për zgjedhjen e kryetarit të Autoritetit të Mediave Audiovizive..... 10175
Rezolutë e Kuvendit datë 1.7.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2020..... 10175
Rezolutë e Kuvendit datë 1.7.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit për vitin 2020..... 10177

Rezolutë e Kuvendit datë 1.7.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2020.....	10179
Rezolutë e Kuvendit datë 7.7.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2020.....	10181
Rezolutë e Kuvendit datë 7.7.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2020.....	10182
Rezolutë e Kuvendit datë 7.7.2021	Për vlerësimin e punës së Departamentit të Administratës Publike (DAP) për gjendjen në shërbimin civil për vitin 2020.....	10184
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 412, datë 8.7.2021	Për miratimin e flamurit, stemës dhe uniformës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.....	10185
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 413, datë 8.7.2021	Për sigurimin e jetës së personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që dërgohen në misione ushtarake dhe stërvitje jashtë vendit, për vitin 2021.....	10190
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 8.7.2021	Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.....	10191
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 415, datë 8.7.2021	Për rregullat e aksesit të subjekteve të interesuara në bazën e të dhënave të Regjistrit Qendror të Llogarive Bankare.....	10192
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 416, datë 8.7.2021	Për një rishpërndarje fondesh, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.....	10195
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 417, datë 8.7.2021	Për miratimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, për programin e zhvillimit të mjedisit.....	10196
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 8.7.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar.....	10202
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 10, datë 2.6.2021	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	10203
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 11, datë 4.6.2021	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	10206

**LIGJ**
Nr. 75/2021

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 21, DATË
19.5.2021, “PËR MIRATIMIN E TEKSTIT
TË MARRËVESHJES SË FURNIZIMIT
NDËRMJET MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE, MINISTRIT TË SHTETIT PËR
RINDËRTIMIN E INSTITUTIT TË
SHËNDETIT PUBLIK DHE
DISTRIBUTORIT TË AUTORIZUAR
‘KEYMEN ILAÇ SANAYI VE
TICARET A.S.’”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të
Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.
21, datë 19.5.2021, “Për miratimin e tekstit të
marrëveshjes së furnizimit ndërmjet Ministrisë së
Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të
Shtetit për Rindërtimin e Institutit të Shëndetit
Publik dhe distributorit të autorizuar ‘Keymen
Ilaç Sanayi ve Ticaret A.S.’”.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 14.6.2021.

LIGJ
Nr. 76/2021

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 22,
DATË 21.5.2021, “PËR MIRATIMIN E
MARRËVESHJES SË NËNSHKRUAR TË
FURNIZIMIT NDËRMJET MINISTRISË
SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE, MINISTRIT TË SHTETIT PËR
RINDËRTIMIN E INSTITUTIT TË
SHËNDETIT PUBLIK DHE
DISTRIBUTORIT TË AUTORIZUAR
‘KEYMEN ILAÇ SANAYI VE
TICARET A.S.’”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të
Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.
22, datë 21.5.2021, “Për miratimin e
marrëveshjes së nënshkruar të furnizimit
ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe
Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Shtetit për
Rindërtimin e Institutit të Shëndetit Publik dhe
distributorit të autorizuar ‘Keymen Ilaç Sanayi ve
Ticaret A.S.’”.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 14.6.2021.

**LIGJ**
Nr. 77/2021

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 23, DATË
26.5.2021, “PËR DISA NDRYSHIME NË
AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË
15.3.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, ‘PËR MARRJEN E
MASAVE TË VEÇANTA
ADMINISTRATIVE GJATË
KOHËZGJATJES SË PERIUDHËS SË
INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA
COVID-19’, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 23, datë 26.5.2021, “Për disa ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, ‘Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19’, të ndryshuar”.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 14.6.2021.

VENDIM
Nr. 61/2021

**PËR EMËRIMIN ANËTAR TË
KËSHILLIT TË STATISTIKAVE**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe të pikave 1 dhe 2, shkronja “b”, të nenit 22, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikat zyrtare”, me propozim të Bankës së Shqipërisë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Emërimin e zonjës Argita Frashëri anëtare të Këshillit të Statistikave.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 1.7.2021.

VENDIM
Nr. 62/2021

**PËR PËRZGJEDHJEN E
KANDIDATËVE, PËR ANËTARË
ZËVENDËSUES, PËR POZICIONET
KOMISIONER TË KOMISIONIT TË
PAVARUR TË KUALIFIKIMIT DHE
KOMISIONER PUBLIK**

Në mbështetje të neneve 10 dhe 11, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; të nenit 17, pika 8, të vendimit të Kuvendit nr. 40/2017, “Për procedurat parlamentare për funksionimin e komisioneve *ad hoc* dhe realizimin e procesit të votimit sipas ligjit nr. 84/2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’”; bazuar në raportin e komisionit *ad hoc* të përzgjedhjes me 12 anëtarë, krijuar sipas vendimit të Kuvendit nr. 60/2021, “Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit Parlamentar *ad hoc*, me 12 anëtarë, për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë zëvendësues për pozicionet komisioner të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisioner Publik”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Miratimin e listës së kandidatëve të zgjedhur, për anëtarë zëvendësues, për pozicionet komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe Komisioner Publik, si më poshtë:



1. Zonja Rozeta Ivanova zëvendësuese për pozicionin komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

2. Zonja Irena Nino zëvendësuese për pozicionin Komisioner Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 7.7.2021.

VENDIM
Nr. 63/2021

PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË
AUTORITETIT TË MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 10, pika 3, shkronja “ç”, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Armela Krasniqi zgjidhet kryetare e Autoritetit të Mediave Audiovizive.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 7.7.2021.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË
PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur Entin Rregullator të Energjisë si rregullatorin e vetëm dhe të pavarur për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike e të gazit natyror, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

Duke vlerësuar që viti 2020 ka qenë një vit shumë i rëndësishëm pasi më 15 nëntor 2020 projekti TAP përfundoi realizimin e tij; ndërtimi i tubacionit tokësor, i cili kalon përmes Shqipërisë ka përfunduar në përputhje me të gjitha kriteret dhe standardet e një projekti të përmasave kaq të mëdha, tashmë Shqipëria është e lidhur me një rrjet ndërkombëtar të gazit;

Duke vlerësuar, gjithashtu, që viti 2020 shënon themelimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX), e cila më 23 tetor 2020 u regjistrua në QKB dhe pritet të bëhet efektive (*Go-Live*) së shpejti duke i hapur rrugën funksionimit të tregut të energjisë së ditës në avancë;

Duke vlerësuar faktin që numri i prodhuesve të pavarur të energjisë elektrike vjen duke u rritur nga viti në vit, duke rritur peshën e këtyre prodhuesve në treg, i cili është një hap i rëndësishëm për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në vendin tonë;

Duke vlerësuar hapat e rëndësishëm të ndërmarrë për rritjen e prodhimit të energjisë elektrike me kosto të ulët përmes diversifikimit të burimeve të rinovueshme të energjisë në Shqipëri nëpërmjet implementimit të planit kombëtar të veprimit për nxitjen e prodhimit të energjisë nga impiante fotovoltaike dhe eolike, si dhe finalizimi me sukses i dy ankandëve për ndërtimin e impianteve fotovoltaike me kapacitet total të instaluar 240 MWp;

Duke vlerësuar trendin pozitiv të uljes së nivelit të humbjeve të energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes, i cili vijon të ketë një rënie nga viti në vit, humbjet e energjisë elektrike për vitin 2020 arritën në nivelin 21.48%, duke shënuar një ulje të lehtë krahasuar me nivelin prej



21.79% të vitit 2019, ndërkohë niveli total i arkëtimeve për vitin 2020 është në vlerat prej 95.8 %, tregues ky i konsoliduar vitet e fundit në nivelin mbi 95%;

Duke vlerësuar faktin që viti 2020 është viti i parë i operimit individual të secilës prej shoqërive OSSH sh.a., FSHU sh.a. dhe FTL sh.a., këto shoqëri kanë zhvilluar në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra aktivitetin përkatës sipas licencave që ato zotërojnë,

Vlerëson veprimtarinë e Entit Rregullator të Energjisë gjatë vitit 2020 në këto drejtime:

- Punën e bërë për të garantuar mbarëvajtjen e sektorit të energjisë gjatë situatës së pandemisë COVID-19, ku në bashkëpunim me operatorët e licencuar për shërbimin publik janë marrë të gjitha masat e nevojshme për furnizimin me cilësi dhe siguri të konsumatorëve, si dhe dhënies së shërbimeve përkatëse.

- Bashkëpunimin ndërmjet ERE-s dhe dy autoriteteve të tjera rregullatore të Italisë dhe Greqisë për miratimin e dokumenteve të ndryshme të përbashkëta, si: vendimi i përbashkët për certifikimin e Operatorit të Pavarur të Transmetimit, miratimi i Kodit të Rrjetit të TAP-it etj. Përfundimi i TAP-it në nëntor 2020 ka bërë të mundur që tashmë Shqipëria të jetë e liqë. Adhur me një rrjet ndërkombëtar të gazit.

- Punën e bërë nga ERE në bashkëpunim me ministrinë e linjës për hartimin e legjislacionit sekondar për sektorin e gazit natyror duke kompletuar të gjithë kornizën ligjore për një funksionim normal të tregut të gazit në vendin tonë.

- Punën e bërë për krijimin e tregut të përbashkët të energjisë elektrike Shqipëri–Kosovë, veçanërisht në kuadër të ngritjes së bursës së energjisë, harmonizimit dhe adaptimit të kuadrit rregullator dhe teknik.

- Bashkëpunimin e ERE-s me të gjithë aktorët për sa i përket ngritjes së Bursës Shqiptare të Energjisë, e cila pritet të bëhet efektive (*Go-Live*) gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021.

- Vënien në punë të linjës së interkonjeksionit 400 kV Tiranë (Shqipëri) – Prishtinë (Kosovë), e cila do të përmirësojë sigurinë e furnizimit me energji elektrike për dy vendet tona, duke marrë parasysh faktin se dy vendet tona kanë sisteme

komplementare të prodhimit të energjisë elektrike.

- Rolin dhe kontributin e ERE-s lidhur me ndryshimet ligjore në ligjin nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ku përfshihen edhe impiantet e vetëprodhuesve të energjisë elektrike, si dhe miratimin e akteve të ndryshme, të cilat i shërbejnë rregullimit të tregut të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, si: dielli, era, bimasë etj.

- Punën e bërë nga ERE, e cila, pas konsultimit edhe me Sekretariatit të Traktatit të Energjisë në Vjenë, me vendimin përkatës ka miratuar programin e pajtueshmërisë së OSSH sh.a., i cili synon shmangien e sjelljeve diskriminuese të OSSH sh.a. ndaj pjesëmarrësve të tjerë në tregun e energjisë elektrike.

- Punën e bërë për miratimin e rregullores, kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Enti Rregullator i Energjisë për vitin 2021 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të kërkojë impenjim maksimal nga OSHEE sh.a. për implementimin në një kohë sa më të shkurtër të masave të parashikuara në Planin e Veprimit për Ndarjen Funksionale të OSHEE sh.a., si një hap ngushtësisht të lidhur me liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, hapjen e mëtejshme të tij dhe si një kërkesë e theksuar edhe në progresraportin i KE-së.

2. Në bashkëpunim me Rregullatorin e Kosovës, të marrë masa për hapjen e procesit të përzgjedhjes së NEMO-s (Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike), si dhe për përafrimin e legjislacionit sekondar midis dy vendeve dhe hapave të tjerë të nevojshëm në funksion të bashkimit të tregjeve të dy vendeve tona.

3. Të rrisë bashkëpunimin me Entin Rregullator të Italisë për të bërë të mundur njohjen e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) në komitetet e bursave të vendeve të BE-së.

4. Përmes mundësive të reja në fushën e teknologjisë së informacionit duhet të punojë për zhvillimin dhe implementimin e një sistemi të menaxhimit dhe trajtimit të ankesave, dhënies së



informacionit të saktë e të shpejtë për konsumatorët, si dhe trajtimit në një kohë sa më të shkurtër të ankesave.

5. Të punojë për hartimin e treguesit të matjes dhe vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj klientit që garanton çdo i licencuar në furnizim, për të bërë të mundur ofrimin e një shërbimi cilësor dhe me standarde për konsumatorin.

6. Përmes mjeteve dhe mënyrave të informacionit të mbështesë dhe promovojë kalimin nga një konsumator pasiv, subjekt i tarifave të rregulluara, akteve rregullatore, në një pjesëmarrës aktiv të tregut të energjisë.

7. Duhet të vijojë mbikëqyrjen e performancës së operatorit sa i përket zbatimit të detyrimeve që burojnë nga ligji dhe aktet nënligjore për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve të energjisë elektrike.

8. Përmes miratimit të akteve rregullatore të punojë për nxitjen e investimeve në impiante të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e vogla të rinovueshme, si: dielli, era, bimasë etj., të cilat sjellin një diversifikim gradual të prodhimit të energjisë në vend, një kërkesë e përsëritur edhe në raportet e progresit të BE-së.

9. Të japë ndihmesën e nevojshme dhe të bashkëpunojë me të gjithë aktorët në vend për të bërë të mundur ndërtimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit. Ngritja e infrastrukturës së gazit është me rëndësi, pasi gazi jo vetëm sjell diversifikimin e burimeve në vend dhe është më ekonomik në përdorimin, por ka edhe emetim shumë herë më të vogël në ambient.

10. Lidhur me përdorimin e teknologjive të reja për stacionet e ngarkimit të automjeteve elektrike, përfshirë rregullimin e tarifimit të këtij shërbimi, t'u referohet praktikave të rregullatorëve në vendet e BE-së duke propozuar opsionet dhe zgjidhjet përkatëse.

11. Mbështetur në parimin e hapjes së tregut, parimin e koherencës dhe atë të shpërndarjes së drejtë, të përqendrohet në punën e saj, në promovimin e konkurrencës dhe inovacionit me qëllim uljen e çmimeve për konsumatorin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve.

12. Me qëllim zvogëlimin e barrierave rregullatore dhe shkurtimin e kohës së procedurave rregullatore, të kryejë një analizë *ex-post* të rregulloreve përkatëse.

13. Krahas ndjekjes së problematikave që mund të lindin nga implementimi i projektit pilot të sistemit të ri të faturimit të energjisë elektrike, të konsiderojë mundësinë e instalimit gradual të matësve inteligjentë, bazuar kjo në një analizë kosto-përfitim dhe duke caktuar nivelin e përshtatshëm për zbatimin sipas zonave të ndryshme (urbane, suburban dhe rurale) në varësi edhe të mbulimit me rrjetin e telekomunikacionit.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 1.7.2021.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË UJIT PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur Entin Rregullator të Ujit si një institucion të pavarur publik, përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nivel kombëtar;

Duke pasur parasysh që situata e pandemisë COVID-19 dhe tërmeti i fundvitit 2019 patën ndikimin e tyre negativ në treguesit e performancës së Sektorit të Ujësjetës-Kanalizimeve për vitin 2020;

Duke theksuar se treguesit kryesorë të performancës, për vitin 2020, në Sektorin e Ujësjetës-Kanalizimeve, tregojnë që gjendja në sektor, në krahasim me vitin 2019, paraqet një përkeqësim në drejtim të ujit pa të ardhura, mbulimit të kostove direkte të O&M, normës së arkëtimit, si dhe treguesit mbulimi me FU, ndërkohë që treguesi mbulimi me kanalizime ka mbetur në të njëjtin nivel;

Duke theksuar se ndryshimet ligjore të nevojshme, me gjithë periudhën disaveçare të diskutimit të tyre, ende nuk janë realizuar, si dhe duke nxitur qeverinë dhe gjithë aktorët për të propozuar sa më parë ndryshimet ligjore, të cilat pritet të kenë një ndikim pozitiv si në Sektorin e Ujësjetës-Kanalizimeve, ashtu edhe në lidhje me pavarësinë institucionale dhe operacionale të



ERRU-së, rolit të saj për mbrojtjen e konsumatorit, përcaktimin e saktë të kompetencave dhe shmangien e mbivendosjes së kompetencave, rritjen e efektivitetit etj.;

Duke theksuar nevojën e përmirësimit të aspekteve të menaxhimit nga shoqëritë UK, për t'i bërë ato më të qëndrueshme financiarisht, si dhe për të rritur transparencën e tyre me konsumatorët,

Vlerëson veprimtarinë e Entit Rregullator të Ujit (ERRU) në këto drejtime:

- Përmirësimin e tre treguesve të performancës krahasuar me një vit më parë, konkretisht të nivelit të matjes me 2.1%, kohëzgjatjes së FU-së me afro 0.5%, si dhe eficientës së stafit (staf/1000 lidhje UK), e cila ka pasur një përmirësim prej 0.1%;

- Punën e bërë në drejtëm të përmirësimit dhe pasurimit të instrumenteve rregullatore, sidomos ato që lidhen me analizat e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK;

- Procesin e monitorimit të kryer nga ERRU-ja pranë shoqërisë UK Tiranë për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve, si dhe mundësinë e përdorimit të tij si model praktik e i unifikuar monitorimi në të gjitha shoqëritë UK, me qëllimin kryesor mbrojtjen e konsumatorit në këndvështrimin e së drejtës së tij për t'u ankuar dhe trajtimit të ankesave në mënyrë sa më të drejtë nga ana e shoqërive UK;

- Miratimin e VKM-së përkatëse, në zbatim të ligjit nr. 71/2018, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, 'Për mbrojtjen e konsumatorëve'", i cili pritet të sjellë një mundësi më shumë, përmirësim të procedurave dhe efikasitet të zgjidhjes së problematikave dhe ankesave të konsumatorëve ndaj shoqërive UK, përmes krijimit të një strukture përgjegjëse pranë ERRU-së për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM) midis shoqërive UK dhe konsumatorëve;

- Përpjekjet në procesin e miratimit të tarifave për gjetjen e një balance ndërmjet mbrojtjes së interesit të konsumatorëve dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimit;

- Hapjen e faqes zyrtare të institucionit në një nga rrjetet sociale më të përdorura, si një qasje e re e informimit të publikut dhe e ndërveprimit me të;

- Bashkëpunimin me të gjithë aktorët në sektor sa u takon ndryshimeve ligjore, veçanërisht me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Kuvendi kërkon që Enti Rregullator i Ujit (ERRU), për vitin 2021, të angazhohet në këto drejtime:

- Të kryejë një analizë të detajuar të dokumentit të Bilancit të Ujit të shoqërive UK dhe, kur shoqëritë aplikojnë për tarifa të reja, të kërkojë në mënyrë rigorozë realizimin e objektivave të vëna nga ERRU-ja për këtë tregues. Fakti që shumë shoqëri kanë nivel të mirë të Ujit Pa të Ardhura (UPA) tregon që realisht është e mundur që ky tregues të përmirësohet;

- Të vijojë të jetë proaktive dhe të luajë një rol nxitës e ndërgjegjësuës që të fillojë realizimi i 2 – 3 shembujve pilot të agregimit (bashkimit) të disa shoqërive UK në sektor, duke pasur parasysh avantazhin e ekonomisë së shkallës në përmirësimin e performancës së një sektori mjaft të fragmentarizuar me 57 shoqëri UK;

- Me gjithë përmirësimin e lehtë të treguesit "Eficienca e stafit", gjatë vitit 2020, ERRU-ja të vijojë të ketë prioritet të punës së saj kryerjen e një analizë të thelluar të organigramës dhe numrit të stafit të shoqërive UK, duke justifikuar secilin pozicion të stafit të saj edhe me përshkrimin përkatës të punës, veçanërisht kur shoqëritë aplikojnë për tarifa të reja;

- Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, gjatë vitit 2021, bazuar në monitorimin e kryer pranë shoqërisë UK Tiranë, të punojë për krijimin e një praktike standarde monitorimi për të gjitha shoqëritë UK, me qëllimin kryesor mbrojtjen e konsumatorit në këndvështrimin e së drejtës së tij për t'u ankuar nëpërmjet një procedure ligjore dhe trajtimi i këtyre ankesave të gjejë një zgjidhje sa më të drejtë. Trajtimi i ankesave të konsumatorëve duhet të përfshihet nga ERRU-ja si bonus ose penalitet në vlerësimin e shoqërive UK;

- Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, me miratimin e VKM-së përkatëse, në zbatim të ligjit nr. 71/2018, të punojë për krijimin e strukturës përgjegjëse pranë ERRU-së për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM) midis shoqërive UK dhe konsumatorëve, si një mundësi më shumë, si dhe një përmirësim të



procedurave dhe efikasitetit të zgjidhjes së problematikave dhe ankesave të konsumatorëve;

- Duke qenë se shoqëritë UK në rastet e faturimit aforfe vijojnë të mos respektojnë normativat e miratuara prej 4.5 m³/muaj/frymë për konsumatorët familjarë, në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, gjatë vitit 2021, ERRU-ja të marrë masat për t'u dhënë fund këtyre lloj praktikave jo të drejta të ndërmarra nga shoqëritë UK kundrejt konsumatorëve. Ankesat e konsumatorëve me objekt “anulim i faturimit aforfe” vijojnë të zënë numrin më të madh të ankesave;

- Për eliminimin e problemeve të licencimit të shoqërive UK, për plotësimin e kushteve të aktmiratimit të lejes higjieno-sanitare dhe të inspektimeve që lidhen me to, në bashkëpunim me Inspektoratin Sanitar Shtetëror të merren masa për propozimin e ndryshimeve përkatëse ligjore. Thëksojmë se ky shqetësim është kërkuar të adresohet në mënyrë të përsëritur edhe në rezolutat e mëparshme, por për shkak të situatës së pandemisë COVID-19 ky problem nuk është trajtuar në vitin 2020;

- Duke qenë se treguesi “Norma e arkëtimit” ka pasur një përkeqësim me 3%, gjatë vitit 2020, edhe pse ERRU-ja është treguar agresive në vendosjen e objektivave për shoqëritë UK, të cilat aplikojnë për tarifa të reja, duhet që po kaq rigoroze të tregohet edhe në ndjekjen e përmbushjes së këtyre objektivave dhe të mos lejojë rritje tarifash, në rast se shoqëria UK nuk ka përmbushur objektivat e caktuara për normën e arkëtimit. Rritja e tarifave pa përmirësuar normën e arkëtimit çon në diskriminimin e atyre konsumatorëve të cilët janë më korrektë me pagesat. Nga ana tjetër, fakti që në sektor ka shumë shoqëri që këtë tregues e kanë konstant ose/dhe me përmirësim tregon që është një objektivi i mundshëm për t'u arritur dhe ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive UK;

- Duhet të vijojë përpjekjet për të bërë të mundur promovimin e institucionit, ndërjegjësimin e konsumatorëve për të drejtat e tyre, si dhe për të rritur besimin e konsumatorëve tek ERRU-ja për mbrojtjen e interesave të tyre. Mbrojtja e interesave të konsumatorit duhet të jetë gjithmonë një prioritet i veprimtarisë së ERRU-së;

- Të propozojë një qasje licencimi për skemat e veçanta që përdoren për furnizimin me ujë në

zonat rurale dhe që administrohen nga vetë banorët. Këto skema duhet të jenë të studiuara dhe të mos krijojnë problematika me banorët që e kanë krijuar vetë infrastrukturën për këtë shërbim;

- Në bashkëpunim me institucionet dhe aktorët kryesorë të sektorit UK të hartojë standardet përkatëse të njësive të shërbimit të klientit në territor, për të bërë të mundur lehtësimin e aksesit, mënyrën e pagesës, standardin e shërbimit etj.;

- Të jetë proaktive në të gjitha rastet, ku, pavarësisht performancës së ndërmarrjeve UK në arkëtimin e faturave, të nxisë vendosjen e një sistemi tarifar që është konform analizave bashkëkohore financiare, bazuar në një plan biznesi 5-vjeçar. Kjo duhet të jetë e reflektuar në metodologjinë e rishikuar të vendosjes së tarifave që ERRU-ja duhet të miratojë brenda vitit 2021;

- Për çdo ndërmarrje UK duhet të analizohen indikatorët minimalë të ofrimit të shërbimit, të cilët duhet të përmbushen, në mënyrë që ndërmarrja UK të vijojë të gëzojë licencën.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 1.7.2021.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur AKEP-in si autoritet të pavarur për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

Duke pasur parasysh që situata e krijuar nga pandemia, puna *online*, zhvillimi i mësimin *online* kanë nxjerrë në pah më shumë se kurrë nevojën jo vetëm për akses në shërbimet e internetit, por edhe qasjen në këto shërbime me shpejtësi më të lartë dhe më të qëndrueshme;

Duke theksuar se, pavarësisht uljes së nivelit të të ardhurave totale gjatë vitit 2020 krahasuar me një vit më parë, operatorët e shërbimeve celulare e kanë rritur ndjeshëm nivelin e investimeve në këto rrjete, duke bërë të mundur



një përmirësimin të shërbimeve *broadband*, si edhe përmirësim të cilësisë së thirrjeve zanore;

Duke pasur parasysh që depërtimi i brezit të gjerë fiks të internetit mbetet i ulët, me gjithë rritjen dyshifrore që ka pasur në vitet e fundit;

Duke theksuar se nxitja e investimeve duhet të ketë në fokus zhvillimin e qëndrueshëm digjital të vendit, rritjen e cilësisë së shërbimit, garantimin e të drejtave të konsumatorëve, si dhe nxitjen e konkurrencës së ndershme dhe të lirë në treg,

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare gjatë vitit 2020 në këto drejtime:

- Punën për përballimin me sukses të pandemisë COVID-19 nga pikëpamja e komunikimeve elektronike, si dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera dhe me operatorët për vënien në dispozicion të kapaciteteve të përforcuara, si dhe një numër të madh ofertash për përdoruesit për të pasur akses në shërbimet internet gjatë pandemisë.

- Punën e bërë për përfundimin e analizës së tregut me shumicë të akses origjinitiv në rrjetet celulare, si dhe vendimmarrjen e AKEP-it duke mbajtur parasysh rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës.

- Vendimmarrjen lidhur me analizën e tregut me shumicë të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare, duke lënë në fuqi masat rregullore të përcaktuara në vendimet e mëparshme të Këshillit Drejtues të AKEP-it.

- Punën e bërë në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit lidhur me problemin e tarifimit të konsumatorit për tërheqjen e pakove postare duke bërë të mundur që nga data 1 janar 2021 Posta Shqiptare të mos aplikojë për individët tarifën e dorëzimit të objekteve postare, pakot e vogla apo kolipostat që vijnë nga jashtë vendit.

- Masat administrative të marra ndaj ofruesit të shërbimit universal postar “Posta Shqiptare” sh.a. për mosdorëzimin e pakove në adresën e individit, të cilat kanë dhënë rezultat në përmirësimin e këtij problemi.

- Vendimmarrjen për analizën e tregut të shërbimeve postare, duke përcaktuar shoqërinë “Posta Shqiptare” sh.a., si ofruesi i vetëm që plotëson kushtet ligjore për të ofruar shërbimin universal postar në Republikën e Shqipërisë.

- Ekspertizën ligjore dhe teknike dhënë nga AKEP-i në miratimin e dy akteve nënligjore shumë të rëndësishme, që lidhen me Planin Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm *Broadband* dhe Politikën Spektrale.

- Punën e bërë për hapjen e procedurës së këshillimit publik të dokumentit “Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, e cila përfshin edhe një kapitull të veçantë për personat me të ardhura të ulëta dhe personat me aftësi ndryshe.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2021 të angazhohet në këto drejtime:

1. Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, pas inspektimit të kryer për subjektin “Posta Shqiptare” sh.a., të vijojë me monitorimin e rekomandimeve të lëna për heqjen e plotë të tarifës së dorëzimit të objekteve postare (pakot e vogla ose kolipostat që vijnë nga jashtë vendit për individët), si dhe përmbushjen e detyrimeve për dorëzimin e pakove në adresën e individit nga Posta Shqiptare sh.a., si një kërkesë ligjore dhe e drejtë e konsumatorit.

2. Pas inspektimit të kryer nga AKEP-i për tre sipërmarrësit e rrjeteve celulare, të vijojë monitorimin për përmbushjen e rekomandimeve të dhëna dhe korrigjimin e shkeljeve të konstatuara nga këta sipërmarrës në funksion të zbatimit të rregullores të portabilitetit të numrit, duke bërë të mundur që pajtimtarët të ushtrojnë të drejtën e tyre të portimit të numrit celular sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në aktet rregullore.

3. Të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës për të shmangur praktikat tregtare çorientuese dhe agresive, si dhe ofertat nën kosto të operatorëve që çojnë në deformim të tregut.

4. Pas miratimit të Rregullores për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Përdoruesve të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike Publike, të punojë për zbatimin e kësaj rregulloreje nga operatorët e shërbimeve të komunikimeve elektronike, veçanërisht sa u takon shërbimeve të reja për përdoruesit me aftësi ndryshe, siç është shërbimi *Text Relay* (shërbim i konvertimit të tekstit), i cili i lejon personat që kanë vështirësi në dëgjim dhe/ose në të folur për të kryer/marrë thirrje telefonike, ose opsioneve të propozuara që u vijnë



në ndihmë pajtimtarëve me të ardhura të ulëta, siç është zgjatja e afatit të vlefshmërisë së rimbushjeve në 12+3 muaj dhe të drejtën e pajtimtarit për kompensim për shumat e papërdorura.

5. Të kryejë një vlerësim afatgjatë të parametrave, kapaciteteve dhe strategjive për implementimin e rrjeteve dhe teknologjive të brezit të ri (5G) brenda vitit 2021.

6. Të luajë një rol proaktiv, nga njëra anë, në terma afatshkurtër, për të bërë të mundur marrjen e masave për sistemim të kabllave ekzistuese në bashkëpunim me të gjithë aktorët dhe, nga ana tjetër, në terma afatgjatë, për propozimin e ndryshimeve ligjore/nënligjore për zgjidhjen e këtij problemi.

7. Të bashkëpunojë me operatorët celularë dhe të koordinojë punën për rritjen e mbulimit dhe të cilësisë së shërbimeve në brezat e frekuencave GSM, UMTS dhe LTE në qytetet kryesore të Shqipërisë, rrugët kryesore kombëtare, zonat urbane dhe rurale dhe veçanërisht në pikat turistike, ku konstatohen probleme mbulimi me shërbim.

8. Të bëjë të gjitha përpjekjet për dhënien në përdorim të lotit të mbetur të brezit të frekuencave 800 MHz brenda këtij viti, si dhe të luajë një rol proaktiv, duke bashkëpunuar me të gjithë aktorët në procesin e lirit të brezit 700 MHz (brezi DD2).

9. Të bashkëpunojë me MIE-në për harmonizimin e legjislacionit të fushës së komunikimeve elektronike në përputhje me Kodin e ri Evropian të Komunikimeve Elektronike, kërkesë e cila theksohet edhe në progresraportin e KE-së.

10. Në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale *Broadband* 2020–2025 të punojë për përmbushjen e detyrave që kanë lidhje drejtpërdrejt me AKEP-in, siç janë: përmirësimi i Atlasit *Broadband*, përmirësimi i bashkëpërdorimit të infrastrukturës ekzistuese.

11. Në kuadër të planit të veprimit për politikën spektrale, të krijojë së bashku me AMA-n një inventar të unifikuar, të përbashkët për spektrin radio të përdorur për qëllime komerciale dhe publike, si dhe të hartojnë së bashku me MIE-në dhe AMA-n një metodologji dhe të kryejnë një analizë për tendencat teknologjike bazuar në praktikën e Bashkimit Evropian të nevojave të

ardhshme dhe të kërkesës për spektër radio në sektorët përkatës.

12. Të rrisë përpjekjet për nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimi me AMA-n, e cila do t'i japë një dimension të ri bashkëpunimit në fusha të përbashkëta, që kanë lidhje me punën e dy autoriteteve, veçanërisht në kuadër të programit për politikën spektrale dhe planit të veprimit, miratuar nga qeveria, por edhe në drejtim të parandalimit të piraterisë audiovizive *online*.

13. Të zbatojë platformën e aksesueshme *online* të matjes së cilësisë së shërbimit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë nga përdoruesit, si dhe për të gjithë sipërmarrësit e komunikimeve elektronike që operojnë në të.

14. Të dakordësojë dhe të miratojë marrëveshje ndërkuftare për parandalimin e interferencave në përdorimin e frekuencave.

15. Të miratojë brenda këtij viti modelin e kostos që duhet të zbatohet në tregjet e komunikimeve elektronike në rregullim nga AKEP-i.

16. Të vijoje zbatimin e marrëveshjes Rajonale të *Roamingut* për të bërë të mundur “*Roaming like at home*” nga data 1 korrik 2021 në vendet e Ballkanit Perëndimor.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 1.7.2021.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në grumbullimin, administrimin, ruajtjen dhe dokumentimin e materialeve të kësaj periudhe në Shqipëri;

Duke njohur bashkëpunimin e këtij Instituti me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera vendase e të huaja për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së Institutit;



Duke konsideruar se detyrat kryesore të punës së këtij Instituti kërkojnë mbështetjen e vazhdueshme të organeve shtetërore, medias, shoqërisë civile dhe partnerëve, në funksion të ruajtjes së kujtesës tonë kolektive,

Vlerëson veprimtarinë e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, gjatë vitit 2020, në këto drejtime:

- Informimin publik për krimet e komunizmit përmes rikrijimit të trashëgimisë materiale të komunizmit përmes projekteve digjitale;

- Rritjen e veprimtarisë në sektorin e edukimit shkollor të të gjitha niveleve, me gjetjen e formave sa më interaktive të përcjelljes së historisë së komunizmit, për një impakt sa më të fuqishëm tek të rinjtë;

- Sensibilizimin publik dhe institucional për trashëgiminë materiale të periudhës komuniste dhe rëndësinë e saj, si dhe vitalizimin e kësaj trashëgimie përmes dokumentimit filmik dhe ekspozitave;

- Evidentimin e rasteve të reja të persekutimit, dënimeve me burg dhe internim përmes zgjerimit të databazës dhe numrit të ri të Fjalorit Enciklopedik të Viktimave të Komunizmit;

- Vazhdimësisë së projekteve afatgjata, në lidhje me kërkimin arkivor dhe dëshmitë verbale, siç është pasurimi i databazës dhe arkiva e video-regjistrimeve;

- Ndërkombëtarizimin e historisë së komunizmit në Shqipëri, përmes projekteve ndërkombëtare të bashkëpunimit, si pjesë e rrjetit të Platformës Europiane të Kujtesës.

Kuvendi kërkon që Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, për vitin 2021, të angazhohet në këto drejtime:

1. Të aplikojë forma inovative të pasqyrit të veprimtarisë së Institutit brenda vendit, si dhe jashtë tij, si pjesë e rrjetit të institucioneve të Platformës Europiane të Kujtesës.

2. Të rrisë numrin e botimeve të reja nga transkriptimi i arkivës audio-vizuale të ISKK-së.

3. Të rrisë volumin e prodhimeve digjitale duke mundësuar sa më shumë aksesim *online* të materialeve që ISKK-ja prodhon.

4. Të hartojë menjëherë një plan strategjik për veprimtarinë e ISKK-së, për caktimin e prioritetëve dhe objektivave afatgjatë, e më pas detajimin në një plan konkret veprimi.

5. Të rinovojë marrëveshjen me ministrinë përgjegjëse për arsimin, me qëllim rritjen e aksesit në sektorin e edukimit shkollor për përfshirjen në planet dhe programet mësimore të shkollave të të gjitha niveleve të informacionit të mjaftueshëm, për krimet e komunizmit dhe të pasojave të tij në Shqipëri.

6. Të intensifikojë bashkëpunimin me institucione homologe të huaja, me qëllim përthithjen e eksperiencave më të mira nga veprimtaria e tyre.

7. Të hartojë Kodin Etik dhe Rregullat e Sjelljes për institucionin.

8. Në funksion të transparencës dhe informimit, të bëjë publike në faqen *online* të institucionit, si dhe në raportin vjetor që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë të gjithë procedurën e rekrutimit të Këshillit Shkencor dhe veprimtarinë e tij, si dhe formularët e vetëdeklarimit të personave që janë pjesë e organeve drejtuese të institucionit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 7.7.2021.

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË
SË AVOKATIT TË POPULLIT
PËR VITIN 2020**

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin dhe rëndësinë e organeve të barazisë në një shoqëri demokratike, ku të drejtat dhe liritë themelore të çdo individi duhet të respektohen;

Duke vlerësuar rolin e Avokatit të Popullit si institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike;

Duke vlerësuar angazhimin e Avokatit të Popullit për të kryer funksionin e tij në përputhje me legjislacionin kombëtar, por edhe me atë ndërkombëtar (veçanërisht Parimet e Parisit dhe të Komisionit të Venecias),



Vlerëson veprimtarinë e Avokatit të Popullit për vitin 2020 në drejtim të:

Riakreditimit të këtij institucioni me Statusin A nga Nënkomiteti i Akreditimit (SCA).

Trajtimin të një numri më të lartë të ankesave/kërkesave nga një vit më parë.

Përfundimit të hetimit administrativ të një numri të konsiderueshëm rastesh.

Adresimit të rekomandimeve drejtuar organeve të administratës publike, duke përfshirë atë qendrore dhe vendore.

Realizimit të monitorimeve dhe inspektimeve.

Monitorimit për nivelin e respektimit të të drejtave të të moshuarve, të akomoduar në institucionet e përkujdesjes shoqërore, nëpërmjet inspektimeve *online*, përkatësisht në Shtëpitë e të Moshuarve Gjirokastër, Shkodër, Kavajë, Fier, Tiranë dhe Qendra Polivalente Poliçan.

Inkurajimit dhe mbështetjes nga Avokati i Popullit për organizatat e shoqërisë civile për vijimin e mbështetjes për viktimat e dhunës, qoftë me këshillimet *online* ose shërbime të çdo natyre tjetër që ato ofrojnë, duke e vlerësuar ofrimin e këtyre shërbimeve si shumë të rëndësishme për periudhën e pandemisë.

Angazhimeve të marra nga institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijës.

Realizimit të inspektimeve periodike (fizike dhe *online*), kontrole me tematikë të veçantë, si dhe vizita inspektuese në të gjitha institucionet e privimit të lirisë nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT).

Përpjekjeve të Avokatit të Popullit për të qenë në ndihmë të grave, vajzave dhe komunitetit LGBTI, në veçanti në kuadër të vështirësive të hasura nga dhuna në familje për shkak të izolimit në shtëpi gjatë periudhës së pandemisë, si dhe problemeve ekonomiko-shoqërore të shfaqura për këto kategori.

Angazhimit të institucionit të Avokatit të Popullit për ngjarjet që lidhen me shembjen e Teatrit Kombëtar, si dhe rekomandimet e lëna për institucionet e përfshira.

Monitorimit të protestave të kryera gjatë muajit maj dhe dhjetor të vitit 2020.

Angazhimit të Avokatit të Popullit për monitorimin e veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, si dhe në kuadër të

monitorimit të institucioneve të rivlerësimit në kuadër të zbatimit të reformës në drejtësi.

Angazhimit të Avokatit të Popullit duke u përfshirë në fazën e konsultimit të jashtëm për projekakte të propozuara nga ministritë e linjës, si dhe përfshirjes në procesin legjislativ për dhënien e mendimeve apo sugjerimeve për projektligje të ndryshme, gjithashtu kontributin e dhënë në kuadër të bashkëpunimit për procesin e integritetit evropian.

Angazhimit dhe pjesëmarrjes së Avokatit të Popullit në takime dhe aktivitete të organizuara në kuadër të bashkëpunimi ndërkombëtar.

Nënshkrimit me UNICEF-in të marrëveshjes së re të bashkëpunimit për periudhën 1 tetor 2020 – 30 shtator 2021, e cila i referohet planit të punës 2020–2021 mes UNICEF-it dhe qeverisë shqiptare.

Nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit midis Avokatit të Popullit dhe Institutit të Statistikave “Për bashkëpunimin në fuqizimin e mbledhjes së të dhënave, përhapjen dhe analizën në dritën e të drejtave të njeriut dhe Agjendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030”.

Kuvendi kërkon që Avokati i Popullit për vitin 2021 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të merren masa proaktive nga ana e Avokatit të Popullit në lidhje me informimin e qytetarëve në forma më gjithëpërfshirëse apo të aksesueshme mbi njohuritë për të drejtat dhe liritë themelore të tyre dhe mekanizmat mbrojtës, duke u angazhuar konkretisht për realizimin e aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit 2018–2022, si krijimi i blogut për të drejtat e njeriut - Histori suksesi, në mbrojtje të të drejtave të njeriut brenda faqes zyrtare të AP-së.

2. Të vijojë organizimin e sesioneve informuese në shkolla 9-vjeçare dhe të mesme në rang vendi, me qëllim përmirësimin e njohurive të nxënësve dhe stafit pedagogjik për të drejtat e tyre themelore dhe punën e AP-së në mbrojtjen e këtyre të drejtave.

3. Të përcjellë në Kuvend një raport të detajuar për çështjet e dhunës në familje, si dhe abuzimit seksual ndaj të miturve.

4. Të zbatohet marrëveshja e bashkëpunimit mes Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke marrë masa konkrete për zbatimin e saj.



5. Të merren masa konkrete për zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara gjatë vitit 2020, si: “Memorandumi i Mirëkuptimit midis Avokatit të Popullit dhe Institutit të Statistikave “Për bashkëpunimin në fuqizimin e mbledhjes së të dhënave, përhapjen dhe analizën në dritën e të drejtave të njeriut dhe Agjendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030” dhe marrëveshjes së nënshkruar me UNICEF-in “Marrëveshja e re e bashkëpunimit për periudhën 1 tetor 2020 – 30 shtator 2021”, e cila i referohet planit të punës 2020–2021 mes UNICEF-it dhe qeverisë shqiptare.

6. Të monitorojë ofrimin e shërbimit shëndetësor në spitalet rajonale, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor falas që u ofrohet qytetarëve, si dhe adresimin e shkeljeve sistematike.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 7.7.2021.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE (DAP) PËR GJENDJEN NË SHËRBIMIN CIVIL PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e DAP-it, si njësi përgjegjëse në kuptim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave shtetërore në shërbimin civil, mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore;

Duke mbështetur DAP-in për zhvillimin e mëtejshëm të një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të paanshëm, të pavarur dhe të bazuar në meritë;

Duke konsideruar përparësinë e zhvillimit të mëtejshëm të reformës së administratës publike si një prioritet kyç për hapjen e negociatave të pranimit në Bashkimin Evropian;

Vlerëson veprimtarinë e Departamentit të Administratës Publike për vitin 2020 në drejtim të:

Plotësimit të vendeve vakante sipas planit vjetor të pranimit për vitin 2020 në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil.

Kryerjes së procedurave të lirimimit nga shërbimi civil të nëpunësve civilë, sipas legjislacionit në fuqi.

Kryerjes së procedurave të punësimit për kategorinë e studentëve të ekselencës në administratën shtetërore.

Kryerjes së procedurave për ecurinë disiplinore të nëpunësve civilë gjatë vitit 2020. Zbatimit dhe monitorimit të Planit të Veprimit 2018–2022 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike.

Administrimit dhe përpunimit të formularëve të vetëdeklarimit të plotësuar nga subjektet vetëdeklaruese në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.

Menaxhimit të një sistemi të posaçëm nëpërmjet platformës së bashkëpunimit “administrata.al”, në të cilin administrohet informacion i hollësishëm për ecurinë e proceseve gjyqësore dhe vendimet e formës së prerë.

Menaxhimit të çështjeve në kuadër të ndjekjes së proceseve gjyqësore.

Rishikimit të strukturave dhe organikave të institucioneve të administratës shtetërore gjatë vitit 2020, bazuar në nevojat e tyre për një organizim më të mirë të punës dhe rialokim më të mirë të burimeve njerëzore në dispozicion.

Zhvillimit të aktiviteteve në bashkëpunim me ReSPA (Shkolla Rajonale e Administratës Publike).

Shtirjes së Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) në institucionet e administratës publike.

Ofrimit të trajnimeve online nga ASPA, si dhe vlerësimit me çmimin “Public Administration Award 2020”, në kategorinë e-Learning, organizuar nga ReSPA dhe OECD për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Vlerësimit të nevojave nga ana e ASPA-s për trajnim për periudhën 2021–2022 për institucionet qendrore, të pavarura dhe vendore.



Ngritjes së fondit të parë të bibliotekës lidhur me modulet e trajnimit që ka ASPA, i mbështetur nga projekti IPA 2014 “Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike”.

Kuvendi kërkon që Departamenti i Administratës Publike për vitin 2021 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të mundësojë realizimin e procedurave të konkurrimit për pozicionet e nivelit ekzekutiv në përputhje me parimet e përcaktuara në ligjin për shërbimin civil, me qëllim garantimin e një procesi përzgjedhës transparent, të drejtë dhe objektiv të nëpunësve civilë, si dhe kryerjen në mënyrë sa më efektive të procedurave të rekrutimit.

2. Të vijojë intensivisht punën për hedhjen e të dhënave në sistemin HRMIS të dosjeve të personelit të administratës publike.

3. Të vlerësojë mundësinë e krijimit të një hapësire në faqen *web* për ofrimin e asistencës *online* për nevoja konsulente nga institucionet e administratës në nivel qendror dhe vendor për procedurat e administrimit në shërbimin civil.

4. Të vijojë përpjekjet për rritjen e besimit të qytetarët e interesuar për të marrë pjesë në procedurat e kryera nga DAP-i për punësimin në bazë të meritës, duke garantuar dhe zhvilluar një proces transparent dhe të drejtë konkurrimi dhe gjenerimin e informacioneve në kohë reale në faqen *web* të DAP-it.

5. Të angazhohet në përmirësimin e procesit të planifikimit vjetor të nevojave për rekrutim të institucioneve, duke krijuar kështu një plan pune të zbatueshëm, shoqëruar me një manual praktik lidhur me planifikimin vjetor të burimeve njerëzore.

6. Të hartojë dhe miratojë një manual për procedurat e parashikuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me qëllim zbatimin e tyre në administratën vendore, e cila shfaq probleme vazhdimisht në interpretimin dhe zbatimin e tij.

7. Të hartojë manualin e procedurave për procese vertikale për secilën nga ministratë e linjës.

8. Të vijojë aplikimin e trajnimeve *online* për administratën vendore për procedurat e popullimit të sistemit HRMIS.

9. Të përgatisë ndryshimet e nevojshme ligjore dhe nënligjore për përmirësimin e metodologjisë së klasifikimit të pozicioneve të

punës, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

10. Të përgatisë ndryshimet e nevojshme ligjore dhe nënligjore për përmirësimin e metodologjisë së vlerësimit të performancës së nëpunësve civilë për një vlerësim objektiv dhe të bazuar në meritë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 7.7.2021.

**VENDIM
Nr. 412, datë 8.7.2021**

**PËR MIRATIMIN E FLAMURIT,
STEMËS DHE UNIFORMËS SË
AGJENCISË KOMBËTARE TË
MBROJTJES CIVILE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 23, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e flamurit, stemës dhe uniformës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, sipas specifikimeve përkatëse të anekseve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Flamuri, stema dhe uniformat e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për nga qëllimi i përdorimit, i përkasin vetëm strukturës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ANEKSI NR. 1 FLAMURI I AKMC-së



Flamuri i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile përbëhet nga këto elemente figurative:

Pjesa valëvitëse e flamurit përbëhet nga një copë mëndafshi me ngjyrë të bardhë me përmasa 140x100 cm. Në mes të flamurit është e vendosur stema e AKMC-së. Flamuri konturohet nga një shirit kuqezi.

Pjesa jovalëvitëse e flamurit përbëhet nga një shtizë cilindrike, me majë, me ngjyrë të argjendtë.

Stema e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile përbëhet nga këto elemente figurative:

- shqiponja dykrenare;
- trekëndëshi ngjyrë blu;
- rrethi ngjyrë portokalli;

- shiriti ngjyrë blu rreth e përqark stemës, ku është shkruar emërtimi i plotë i institucionit, brenda të cilit janë të vendosur 4 (katër) yje pesëcepëshe.

Trekëndëshi me ngjyrë blu, si edhe rrethi ngjyrë portokalli janë pasqyrim i përcaktimeve të nenit 66, të protokollit 1, të Konventës së Gjenevës, të 12 gushtit 1949, “Mbi shenjat ndërkombëtare të mbrojtjes civile”.

Shqiponja e vendosur në qendër të stemës tregon elementin kombëtar të flamurit dhe përfaqëson tërësinë e territorit të Republikës.

Vendosja e saj brenda trekëndëshit blu simbolizon misionin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit 45/2019, ku përcaktohet se AKMC-ja përgjigjet për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Katër yjet pesëcepëshe përfaqësojnë qendrat e mbrojtjes civile, si degëzime të AKMC-së, në të gjithë territorin e vendit.

Interpretimi i ngjyrave të elementeve përbërëse të stemës është, si më poshtë:

- ngjyrat e kuqe dhe e zezë simbolizojnë ngjyrat e flamurit kombëtar;
- ngjyra blu simbolizon fatkeqësitë natyrore, përmbytjet;
- ngjyra portokalli simbolizon tërmetet, rrëshqitjet e tokës, zjarret.

ANEKSI NR. 2 STEMA E AKMC-së

Stema e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile përbëhet nga këto elemente figurative:

- shqiponja dykrenare;
- trekëndëshi ngjyrë blu;
- rrethi ngjyrë portokalli;
- shiriti ngjyrë blu rreth e përqark stemës, ku është shkruar emërtimi i plotë i institucionit, brenda të cilit janë të vendosur 4 (katër) yje pesëcepëshe.

Trekëndëshi me ngjyrë blu, si edhe rrethi ngjyrë portokalli janë pasqyrim i përcaktimeve të nenit 66, të protokollit 1, të Konventës së Gjenevës, të 12 gushtit 1949, “Mbi shenjat ndërkombëtare të mbrojtjes civile”.

Shqiponja e vendosur në qendër të stemës tregon elementin kombëtar të flamurit dhe përfaqëson tërësinë e territorit të Republikës.

Vendosja e saj brenda trekëndëshit blu simbolizon misionin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit 45/2019, ku përcaktohet se AKMC-ja përgjigjet për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Katër yjet pesëcepëshe përfaqësojnë qendrat e mbrojtjes civile, si degëzime të AKMC-së, në të gjithë territorin e vendit.

Interpretimi i ngjyrave të elementeve përbërëse të stemës është, si më poshtë:

- ngjyrat e kuqe dhe e zezë simbolizojnë ngjyrat e flamurit kombëtar;
- ngjyra blu simbolizon fatkeqësitë natyrore, përmbytjet;
- ngjyra portokalli simbolizon tërmetet, rrëshqitjet e tokës, zjarret.

Logo me permasat "REALE"
30 mm x 30 mm



Logo me permasat "JO-REALE"



ANEKSI NR. 3 UNIFORMA E AKMC-së

Uniforma e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile përbëhet nga:



1. Xhupi

Një xhup ngjyrë blu të errët, dopio shtresë, ku shtresa e jashtme mbron nga shiu dhe era dhe ajo e brendshme me një material i cili ruan nxehtësinë. Në pjesën e gjoksit ndodhet një shirit identifikues ku mund të vendoset emri ose një logo. Xhupi përbëhet nga disa xhepa në pjesën e krahëve dhe në pjesën ballore. Një shirit reflektues ndodhet në fundin e xhupit dhe te mëngët. Kapuçi mund të hiqet sipas nevojës.

Material kundër Erës



2. Jelevu

Një jelev material kundër erës. Në pjesën ballore gjendet emri bashkë me stemën e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Në pjesën e pasme shkruhet “Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile” dhe poshtë saj vendoset stema e agjencisë.



3. Kapela

Kapelë me material rezistent ndaj diellit. Në pjesën ballore është stema e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Në krah është stema



Në krah është flamuri





4. Bluza

Në varësi të stinës, bluza është me krahë të gjata dhe të shkurtra. Ngjyra e saj është blu e errët dhe materiali është elastik dhe që nuk ruan lagështirën. Në pjesën ballore është emri dhe në krahë ndodhet stema e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe flamuri i Republikës së Shqipërisë.



5. Pantallonat

Pantallonat janë ngjyrë blu të errët, me material elastik dhe rezistent nga ujit. Kanë 8 xhepa për përdorim.



6. Këpucët

Gjysmëçizme me ngjyrë të zezë. Janë të lehta dhe të rehatshme. Mbajnë këmbët të freskëta, të thata dhe të rehatshme gjatë gjithë ditës. Poshtë përbëhen nga material rezistent ndaj rrëshqitjes. Pjesa lart përbëhet nga material lëkure dhe najlon 840D.

VENDIM

Nr. 413, datë 8.7.2021

PËR SIGURIMIN E JETËS SË PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË DËRGOHEN NË MISIONE USHTARAKE DHE STËRVITJE JASHTË VENDIT, PËR VITIN 2021

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 5, të nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me bashkimin e operatorëve ekonomikë “SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a., “SICRED” sh.a., “INSIG JETË” sh.a. dhe “ALBSIG JETË” sh.a., të bëjë sigurimin e jetës së personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që dërgohen në misione ushtarake dhe stërvitje jashtë vendit, për vitin 2021.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar për vitin 2021.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**



VENDIM
Nr. 414, datë 8.7.2021

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE
DHE KRITEREVE TË NDARJES DHE
TË PËRDORIMIT TË FONDIT TË
KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË
SHTETIT PËR MBROJTJEN CIVILE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 65, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkitë, për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjes civile, të përfitojnë nga buxheti qendror një fond të kushtëzuar për mbrojtjen civile.

2. Kriteret e përgjithshme të ndarjes së fondit të kushtëzuar, të akorduar nga buxheti qendror dhe dokumentet orientuese për përdorimin e këtij fondi, duhet të bazohen në:

a) strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë;

b) vlerësimin vendor të riskut;

c) planin vendor të emergjencave civile;

ç) planin e zhvillimit urban.

3. Fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të përdoret sipas prioritizimit, si më poshtë vijon:

3.1 60 (gjashtëdhjetë) % – 100 (njëqind) % e fondit të dedikuar për mbrojtjen civile mund të përdoret për:

a) akordimin e ndihmës financiare për familjet, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera, sipas kriterëve specifike të përcaktuara në aktet nënligjore që rregullojnë ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, neni 41;

b) marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objektet infrastrukturore që përbëjnë një kërcënim serioz për jetën e njerëzve, pronat e tyre dhe mjedisin, të cilat ndikojnë në rikthimin e jetës normale për komunitetin e veprimtaritë e tij ekonomike;

c) shërbime të ndërhyrjes së menjëhershme në shpëtimin e jetës së shtetasve, pronës private e

publike, si dhe mbrojtjen e mjedisit, të cilat janë dëmtuar ose kërcënohen nga fatkeqësi të ndryshme;

ç) ngritjen, përditësimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave;

d) mirëmbajtjen dhe për funksionimin e sistemit të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm të njoftimit dhe alarmit;

dh) mbajtjen në gatishmëri të sistemeve të mbrojtjes nga zjarri, kalueshmërinë e pandërprerë të rrugëve rurale, vendet e strehimit, si dhe mbledhjen e administrimit të rezervave ushqimore për njerëzit dhe gjënë e gjallë;

e) mbajtjen në gatishmëri të infrastrukturës së ujitjes, të kullimit, të mbrojtjes nga përmytja dhe digat e rezervuarëve në administrim të tyre;

ë) shpenzime të kryera për blerje karburanti dhe pjesë ndërrimi për automjete dhe makineri, të cilat përdoren për përballimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e një fatkeqësie;

f) mbulimin e shpenzimeve të tjera operative të kryera gjatë përballimit të ngjarjeve dhe situatave të emergjencës civile;

g) blerje materialesh të ndryshme, që i shërbejnë veprimtarisë së strukturave të emergjencës civile në nivel vendor;

gj) marrjen e masave mbrojtëse, parandaluese dhe për financimin e objekteve që ndikojnë në rikthimin e jetës normale për komunitetin dhe veprimtaritë e tij ekonomike;

h) likuidimin e detyrimeve fiskale, taksa portuale dhe tatime, të shpenzimeve të transportit dhe akomodimit të forcave, mjeteve të specializuara të vendit dhe të huaja, të pajisjeve dhe makinerive të marra me qira dhe të dhuruara, si dhe për magazinimin e tyre.

3.2 Në rast se do lindë nevoja dhe do të teprojnë fonde nga pika 3.1, fondi i dedikuar për mbrojtjen civile mund të përdoret deri në masën 30 (tridhjetë) % për:

a) plotësimin e strukturave operacionale me pajisje dhe trajnime në fushën e mbrojtjes civile;

b) marrjen me qira të pajisjeve, mjediseve private, mjeteve motorike, mjeteve ajrore dhe makinerive të ndryshme, si dhe për dëmin e shkaktuar nga ekzekutimi i punimeve në pasuritë e paluajtshme të shtetasve në përballimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e një fatkeqësie, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi;



c) organizimin e fushatave të sensibilizimit dhe informimit të komunitetit në fushën e mbrojtjes civile dhe reagimit ndaj fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera;

ç) përditësimin e strategjisë, dokumentit të vlerësimit të riskut dhe planit të emergjencave civile për reduktimin e riskut nga fatkeqësitë, në nivel vendor dhe planet e evakuimit;

d) mbështetjen financiare të operacioneve me forca dhe mjete të bashkive të tjera apo të huaja, në raste të fatkeqësive natyrore apo fatkeqësive të tjera.

3.3. Sipas rastit dhe në qoftë se do të teprojnë fonde nga pikat 3.1 dhe 3.2, fondi i dedikuar për mbrojtjen civile mund të përdoret deri në masën 10 (dhjetë) % për:

a) aktivizimin e kapaciteteve të subjekteve publike e private brenda territorit administrativ të tyre, për të bashkëpunuar dhe për të asistuar bashkitë fqinje, në rastet kur kjo e fundit është prekur nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi tjetër;

b) veprimtari të ndryshme që organizojnë strukturat përgjegjëse të mbrojtjes civile, për aktivitetet, trajnimet dhe shërbimet që ndikojnë direkt në forcimin e këtyre strukturave;

c) botime, për veprimtari kërkimore-shkencore, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, dhe aktivitete të tjera në interes të strukturave të mbrojtjes civile.

4. Në rast se konsiderohet e nevojshme të tejkalohej përqindjet e parashikuara nga pikat 3.1, 3.2 dhe 3.3, ky tejkallim duhet të autorizohet me një vendim të Këshillit Bashkiak.

5. Përdorimi i fondeve, sipas përcaktimeve më sipër, miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak.

6. Prefekti, pas konfirmimit të ligjshmërisë së vendimit të Këshillit Bashkiak, informon Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

7. Bashkitë, 1 (një) herë në 4 (katër) muaj, duhet të raportojnë për përdorimin e fondeve, mënyrën e përdorimit të tyre te Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe te Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

8. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, bashkitë dhe prefektët e qarqeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 415, datë 8.7.2021

**PËR RREGULLAT E AKSESIT TË
SUBJEKTEVE TË INTERESUARA NË
BAZËN E TË DHËNAVE TË
REGJISTRIT QENDROR TË
LLOGARIVE BANKARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 154/2020, “Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë nivelin e aksesimit të subjekteve të interesuara, të përcaktuara në pikën 10, të nenit 4, të ligjit nr. 154/2020, “Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare”, në bazën e të dhënave shtetërore, Regjistri Qendror i Llogarive Bankare dhe i kasetave të sigurisë, në vijim Regjistri, në përputhje me parashikimet e nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, si dhe të pikës 2, të nenit 1, të vendimit nr. 945, datë 2.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore’”, të ndryshuar.

2. Në përputhje me nenin 6, të ligjit nr. 154/2020, “Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare”, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit garantojnë funksionimin normal, pa ndërprerje, të Regjistrit Qendror të Llogarive Bankare dhe të kasetave të sigurisë.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve garanton funksionimin e përditësuar të Regjistrit Qendror të Llogarive Bankare dhe të kasetave të sigurisë.



4. Institucionet financiare janë përgjegjëse për saktësinë dhe plotësinë e të dhënave të raportuara në Regjistrë.

II. KRITERET PËR PËRDORIMIN E REGJISTRIT DHE AKSESIN PËR PËRDORUESIT

1. Aksesit i subjekteve të interesuara në Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare kryhet drejtpërdrejtë në mënyrë elektronike përmes të dhënave për përdoruesin dhe kodin hyrës.

2. Subjektet e interesuara, sipas pikës 10, të nenit 4, të ligjit nr. 154/2020, “Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare”, përcaktojnë përdoruesit që do të kenë akses në të dhënat e këtij Regjistri, bazuar në kriterin nevojë për njohje.

3. Kërkesa me shkrim për pajisjen me kodin hyrës i paraqitet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke bashkëlidhur për secilin përdorues të dhënat sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve pajis me kod hyrës secilin përdorues brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës me shkrim.

5. Kodet hyrëse nuk mund t’u bëhen të ditur personave të tretë, të ndryshëm nga përdoruesit.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Shërbimi Informativ i Shtetit paraqesin kërkesë për pajisje me kodet hyrëse pa zbuluar identitetin e përdoruesit. Në këtë kuptim, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Shërbimi Informativ i Shtetit do të jenë mbajtës/përgjegjës të kodeve hyrëse dhe me akt të brendshëm duhet të bëjnë identifikimin e kodit me përdoruesin.

7. Përdoruesit duhet të përdorin të dhënat e përfituara nga Regjistri vetëm për qëllime të përmbushjes së detyrave funksionale, duke zbatuar legjislacionin në fuqi.

8. Ekstrakti i rezultatit të kërkimit në regjistrë mundësohet *online*, menjëherë, dhe mund të shkarkohet apo të printohet nga përdoruesit, i firmosur në mënyrë digjitale nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

9. Subjektet e interesuara i ruajnë të dhënat e mbledhura nga Regjistri, jo më gjatë sesa koha e parashikuar në nenin 11, të ligjit nr. 154/2020, “Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare”.

10. Regjistri aksesohet vetëm nga përdoruesit e subjekteve të interesuara.

III. LLOJI I TË DHËNAVE TË AKSESUESHME NGA PËRDORUESIT E AUTORIZUAR NGA SUBJEKTET E INTERESUARA

1. Subjektet e interesuara si më poshtë:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave;

b) Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm;

c) Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;

ç) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;

d) Byroja Kombëtare e Hetimit;

dh) Shërbimi Informativ i Shtetit;

kanë akses të plotë, të menjëhershëm dhe të pafiltruar në të dhënat e Regjistrit, nëpërmjet përdoruesve të autorizuar prej tyre.

2. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, nëpërmjet përdoruesve të autorizuar, ka akses të plotë, të menjëhershëm dhe të pafiltruar në të dhënat e Regjistrit, përveç të dhënave sipas pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 154/2020, “Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare”.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në ushtrim të funksioneve të saj për mbledhjen e të ardhurave nëpërmjet personave të autorizuar, ka akses të plotë, të menjëhershëm dhe të pa filtruar në të dhënat e Regjistrit.

4. Drejtoritë e taksave dhe të tarifave pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet përdoruesve të autorizuar prej tyre, kanë akses të plotë, të menjëhershëm dhe të pafiltruar në të dhënat e Regjistrit, përveç të dhënave:

a) sipas pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 154/2020, “Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare”;

b) sipas shkronjave “e”, “ë”, “f” dhe “g”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 154/2020, “Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare”.

5. Subjektet e interesuara nuk kanë kufizime në numrin e personave që mund të autorizohen për të pasur akses në Regjistrë, por kanë kufizime në kategorinë e punonjësve që mund të autorizojnë, më konkretisht:



a) për Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Shërbimin Informativ të Shtetit, përdoruesit e autorizuar trajtohen sipas pikës 6, të kreut II, të këtij vendimi;

b) për Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Byronë Kombëtare të Hetimit, përdoruesit e autorizuar janë vetëm prokurorët dhe punonjësit që sipas ligjit gëzojnë statusin e oficerit të policisë gjyqësore, pa përfshirë administratën;

c) për Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave përdoruesit e autorizuar janë vetëm inspektorët, të cilët janë përgjegjës për kontrollin e pasurisë, pa përfshirë administratën;

ç) për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në ushtrim të funksioneve të saj për mbledhjen e të ardhurave, përdoruesit e autorizuar janë vetëm punonjësit sipas strukturës së miratuar, të cilët kanë në fushën e përgjegjësisë shtetërore mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara, kontrollin e specializuar dhe hetimin tatimor, pa përfshirë administratën;

d) për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, përdoruesit e autorizuar janë vetëm punonjësit sipas strukturës së miratuar, të cilët kanë në fushën e përgjegjësisë shtetërore mbledhjen e detyrimeve dhe hetimin doganor, pa përfshirë administratën;

dh) për drejtoritë e taksave dhe tarifave pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, përdoruesit e autorizuar janë vetëm punonjësit sipas strukturës së miratuar, të cilët kanë në fushën e përgjegjësisë shtetërore mbledhjen e detyrimeve, pa përfshirë administratën;

e) për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, përdoruesit e autorizuar janë vetëm punonjësit sipas strukturës së miratuar, të cilët kanë në fushën e përgjegjësisë shtetërore krimin ekonomik dhe financiar, financimin e terrorizmit dhe gjurmimin e aseteve.

6. Nëse subjektet e interesuara konstatojnë se të dhënat e raportuara apo të mbajtura në Regjistrë janë të pasakta apo të paplota, njoftojnë pa vonesë njësinë përgjegjëse për Regjistrin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

7. Institucionet financiare nuk raportojnë të dhëna për gjendjen e llogarive bankare dhe përmbajtjen e kastave të sigurisë, me përjashtim të rasteve ku përcaktohet me vendim gjyqësor.

8. Regjistri mundëson edhe kërkim historik në të dhënat e Regjistrit të mbledhura sipas nenit 8, të ligjit nr. 154/2020, “Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare”.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Subjektet e interesuara njoftojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në rastet kur punonjësit e autorizuar për akses në këtë Regjistrë pezullohen apo largohen nga detyra. Njoftimi bëhet brenda 24 orëve nga pezullimi apo largimi i punonjësit nga institucioni përkatës. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, menjëherë, por jo më vonë se 48 orë nga marrja e njoftimit, realizon bllokimin e kodeve hyrëse për punonjësit përkatës.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, apo çdo person tjetër i përfshirë në krijimin, mirëmbajtjen apo administrimin e Regjistrit, nuk mund të gjurmojnë apo prodhojnë raporte për aktivitetin e kërkimit dhe përdorimit të këtij Regjistri nga subjektet e interesuara të përcaktuara në pikën 10, të nenit 4, të ligjit nr. 154/2020, “Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare”, përveç rasteve kur një raport i tillë kërkohet nga vetë këto institucione.

3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe



Aneks 1

FORMULAR KËRKESE PËR PAJISJE ME KOD HYRËS

Institucioni	
Emri i përdoruesit	
Mbiemri i përdoruesit	
Datëlindja	
Numri Personal	
Funksioni	
Email-i i përdoruesit	
Telefon zyre (nëse ka)	
Telefon celular	

VENDIM
Nr. 416, datë 8.7.2021

**PËR NJË RISHPËRNDARJE FONDESH,
 NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR
 VITIN 2021, NDËRMJET MINISTRISË SË
 FINANCave DHE EKONOMISË DHE
 DREJTORISË SË SHËRBIMEVE
 QEVERITARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, t’i shtohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh, në zërin “subvencion”, për financimin e shpenzimeve funksionale deri në fund të vitit 2021.

2. Fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh përballohet nga buxheti i miratuar, për vitin 2021, për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zërin “shpenzime korrente”, përkatësisht:

a) 4 000 000 (katër milionë) lekë, nga programi buxhetor 01120 “Menaxhimi i shpenzimeve publike”;

b) 5 000 000 (pesë milionë) lekë, nga programi buxhetor 01130 “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme”;

c) 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, nga programi buxhetor 04160 “Mbështetje për mbikëq. e tregut, infrast. e cilës. dhe pron. industr.”;

ç) 4 000 000 (katër milionë) lekë, nga programi buxhetor 04170 “Inspektimi në punë”.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



VENDIM
Nr. 417, datë 8.7.2021

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE AGJENCISË
SUEDEZE PËR BASHKËPUNIM DHE
ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR, PËR
PROGRAMIN E ZHVILLIMIT
TË MJEDISIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, për programin e zhvillimit të mjedisit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

MARRËVESHJE GRANTI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
AGJENCISË SUEDEZE PËR BASHKËPUNIM
DHE ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR PËR
PROGRAMIN E ZHVILLIMIT TË MJEDISIT
NR. I KONTRIBUTIT TË SIDA-s:
12331A0101

Tabela e përmbajtjes

1. Objekti dhe sfondi
2. Objektivat e Programit
3. Zbatimi
4. Granti
5. Disbursimet
6. Menaxhimi financiar
7. Raportimi financiar
8. Raportimi përshkrues

9. Prokurimi
10. Monitorimi
11. Konsultimet dhe takimet vlerësuese
12. Vlerësimet
13. Auditimet
14. Shlyerja e interesit, fitimet nga këmbimi dhe fondet e papërdorura
15. Korrupsioni dhe parregullsia të tjera
16. Mjetet mbrojtëse
17. Vizibiliteti dhe informacioni
18. Referenca të marrëveshjet të tjera
19. Pushimi i fuqisë
20. Periudha e vlefshmërisë së Marrëveshjes
21. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve
22. Njoftimet

Kjo Marrëveshje Granti (Marrëveshja) lidhet ndërmjet

1. Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Nënshkruesi); dhe

2. Agjencisë Suedeze për Bashkëpunimin dhe Zhvillim Ndërkombëtar (për Suedinë), për zbatimin e një programi mbështetës mjedisor me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM),

bashkërisht të referuara si Palët.

1. Objekti dhe sfondi

1.1 Në vitin 2006 Shqipëria dhe Suedia hynë në një Marrëveshje mbi Kushtet e Përgjithshme për Bashkëpunimin Zhvillimor. Suedia tani ka vendosur të japë një Grant që do të përdoret ekskluzivisht për zbatimin e “Programit për mbështetjen e mjedisit”, me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM). Programi do të zbatohet për një periudhë 36-mujore, duke filluar nga data që kjo Marrëveshje hyn në fuqi.

1.2 Palët kanë rënë dakord të hyjnë në një Marrëveshje, e përbërë nga këto kushte specifike dhe anekset e mëposhtme, ku të gjitha këto përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje dhe renditen sipas përparësisë. Në rast të mospërputhjeve ndërmjet kushteve specifike dhe shtojcave, mbizotërojnë kushtet specifike.

Anekset

1.A. Dokumenti i Programit që përshkruan Projektin;

2.B. Buxheti i Programit;

3.C. Termat standardë të referencës së SIDA-s për auditimin vjetor.



4.1.3 Palët bashkëpunojnë dhe komunikojnë rregullisht me njëra-tjetrën për të gjitha çështjet që lidhen me zbatimin e Programit dhe kësaj Marrëveshjeje. Palët informojnë pa vonesë njëra-tjetrën për çdo rrethanë që mund të ndërhyjë ose kërcënojë të ndërhyjë në zbatimin e suksesshëm të Programit dhe ndryshimeve të tjera, me qëllim zgjidhjen e çështjes. Palët zhvillojnë takime nëse ose kur kërkohet nga secila Palë.

5.2. Objektivat e Programit

2.1 Objektivi i përgjithshëm i Programit është të kontribuojë në një mjedis të qëndrueshëm, në përputhje me kërkesat dhe standardet e BE-së që lehtëson procesin e negociatave për kapitullin 27, siç përshkruhet në dokumentin e programit “Programi i mbështetjes për mjedisin”, i datës 17 mars 2020, shtojca A.

2.2 Dokumenti i Programit, përfshirë Kornizën e Rezultateve, si dhe buxhetin në monedhën euro mund të azhurnohen përmes ndryshimeve me shkrim, sa herë që kërkohen ndryshime të rëndësishme për zbatimin efektiv.

3. Zbatimi

3.1 Përfituesi, përmes DPFK-së dhe MTM-së, është plotësisht përgjegjës për zbatimin e Programit dhe për menaxhimin e kontributeve financiare nga Suedia. Si financues, Suedia nuk mban asnjë përgjegjësi dhe/ose detyrim ndaj ndonjë pale të tretë në lidhje me zbatimin e Programit.

3.2 Marrëveshje institucionale dhe të tjera.

3.2.1 Përfituesi ka mandatuar Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) të jetë përgjegjëse kundrejt Përfituesit për zbatimin e Programit. Përfituesi siguron që MTM-ja të kryejë aktivitetet e Programit në përputhje me këtë Marrëveshje.

3.2.2 Përfituesi siguron që gjatë zbatimit të Projektit, Drejtoria e Përgjithshme për Financim dhe Kontraktim e BE-së, Banka Botërore dhe fondet e tjera të donatorëve (DPFK), nën Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të kryejë veprimtari në mirëbesim (prokurim dhe financiar) të mbështetura siç është e nevojshme nga MTM-ja, përfshirë monitorimin dhe vlerësimin e Programit.

3.2.3 Hartimi i një Manuali Operacional rregullon rolet dhe përgjegjësitë e DPFK-së, MTM-së dhe SIDA-s dhe specifikon të gjitha rregullimet institucionale dhe të tjera zbatuese në detaje. Përfituesi e ndan Manualin Operacional me Suedinë për aprovim, brenda 30 ditësh pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Grantit. Manuali

Operacional rishikohet dhe azhurnohet sipas nevojës.

4. Granti

4.1 SIDA merr përsipër të financojë Programin përmes një Granti deri në një shumë maksimale prej 20 300 000 SEK (korona suedeze njëzet milionë e treqind mijë, Granti) që u nënshtrohet ndarjeve buxhetore të Parlamentit Suedeze.

4.2 Granti përdoret ekskluzivisht për të financuar kostot aktuale të zbatimit të Programit gjatë periudhës së aktivitetit. Kostot e paparashikuara që mbulohen nga buxheti i paparashikuar, i nënshtrohen miratimit të Suedisë.

4.3 Përfituesi, përmes MTM-së, është përgjegjës për marrjen e burimeve shtesë që mund të kërkohen për të zbatuar siç duhet Programin. Kjo pasqyrohet në Buxhet dhe përfshihet në raportim.

5. Disbursimet

5.1 Disbursimet janë të kushtëzuara nga përmbushja e kushteve në këtë Marrëveshje, progresi në lidhje me objektivat e Programit dhe rezultatet e pritura, çdo fond i papërdorur, sipas datës së kërkesës për disbursim, si dhe nevojat aktuale financiare, në përputhje me planet vjetore të paraqitura të punës dhe buxhetet.

5.2 Granti disbursohet në këste gjashtëmujore bazuar në nevojën financiare të Programit për periudhën e ardhshme. Nevoja financiare i referohet shpenzimeve të buxhetuara për periudhën e ardhshme, minus fondet në dispozicion të Programit nga të gjitha burimet e tjera gjatë së njëjtës periudhë.

5.3 Fondet e ofruara nga Suedia paguhet në këste pas marrjes dhe miratimit nga Suedia të kërkesave me shkrim për pagesa të nënshkruara nga përfaqësuesi/t i autorizuar i Përfituesit, siç specifikohet në 5.4 më poshtë.

5.4 Një kërkesë me shkrim i dërgohet Ambasadës me informacion mbi titullin e Marrëveshjes dhe ID-në e kontributit siç përcaktohet në preambulën e kësaj Marrëveshjeje.

Kërkesa nënshkruhet nga përfaqësuesit e autorizuar të emëruar nga ministri i Financave dhe Ekonomisë.

Shuma e kërkuar deklarohet në monedhën e Koronës Suedeze (SEK), pavarësisht nga cila monedhë kryhet pagesa. Pagesa kryhet në monedhën e preferuar siç tregohet nga Përfituesi në kërkesë.



a) Pagesa do të bëhet në një valutë të konvertueshme, përveç SEK, me kusht që të jetë shprehur qartë në kërkesë dhe me kusht që llogaria të marrë monedhën e treguar. Kursi i këmbimit i SEK-ut do të bëhet nga banka e SIDA-s, duke ndjekur udhëzimet e pagesës nga SIDA.

Detajet e mëposhtme të plota bankare duhet të përfshihen në kërkesë:

1. emri i bankës;
2. mbajtësi i llogarisë bankare;
3. numri i llogarisë bankare;
4. IBAN (nëse aplikohet);
5. SWIFT/kodi BIC.
6. Monedha e llogarisë

5.5 Kërkesa e parë shoqërohet me një letër dërguar nga banka në SIDA, duke përfshirë një garanci në lidhje me detajet e bankës më sipër.

Kërkesat pasuese të disbursimit duhet të shoqërohen me letra të reja bankare, vetëm nëse Përfituesi ka bërë ndonjë ndryshim, në lidhje me ndonjë nga detajet e bankës të përmendura më lart.

5.6 Pagesa e parë prej 3 milionë koronash suedeze depozitohet në llogarinë/të e përcaktuara bazuar në nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje.

5.7 Pagesat pasuese bëhen bazuar në kërkesat e raportimit në këtë Marrëveshje, si dhe nevojat e likuiditetit, sipas planeve vjetore të punës të paraqitura dhe buxheteve.

5.8 Fondet e ofruara nga Suedia disbursohen nga Suedia në një llogari të veçantë të mbajtur në Bankën e Shqipërisë në emër të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Përfituesi, përmes DPFK-së, i njeh Suedisë menjëherë marrjen e fondeve me shkrim. Deklarata përfshin shumën e marrë në monedhën e marrë, si dhe shumën ekuivalente të kredituar në monedhën vendase.

5.9 Marrësi, përmes MTM-së, pohon se financimi i siguar nga Suedia përdoret ekskluzivisht për të mbuluar shpenzimet e caktuara për Projektin, siç përcaktohet në Dokumentin e Programit.

6. Menaxhimi financiar

6.1 Përfituesi do të mbajë, përmes DPFK-së, një sistem të përshtatshëm të menaxhimit financiar të Projektit, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, siç zbatohet nga administrata publike në Shqipëri.

6.2 Të ardhurat dhe kostot në lidhje me Projektin duhet të jenë lehtësisht të

identifikueshme dhe të verifikueshme. Kostot duhet të tregohen në buxhetin e përgjithshëm të vlerësuar dhe të jenë të nevojshme për zbatimin e Projektit.

7. Raportimi financiar

7.1 Përfituesi, përmes DPFK-së, përgatit dhe i dorëzon Suedisë pasqyrat financiare dhe raportet financiare gjysmëvjetore për Programin jo më vonë se 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti. Raporti i parë financiar që mbulon vitin 2021 do të dorëzohet jo më vonë se 31 mars 2022.

7.2 Raporti financiar gjashtëmuor mbulon periudhat nga 1 janari deri më 30 qershor dhe 1 korrik deri më 31 dhjetor. Pasqyrat financiare/raportet financiare duhet të përmbajnë të ardhurat dhe kostot faktike me një krahasim me buxhetin e aprovuar për periudhën raportuese dhe tregojnë financimin nga Suedia, në formë dhe detaje që lejojnë identifikimin e disbursimeve për Projektin e rënë dakord. Buxheti rishikohet gjatë fazës së fillimit dhe miratohet nga Suedia.

Pasqyrat financiare/raportet financiare nënshkruhen nga drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Financimit dhe Kontraktimit, DPFK.

7.3 Pasqyrat financiare gjashtëmuore dhe raportet financiare duhet të përfshijnë informacion mbi shumën e marrë, si në monedhën e transferimit ashtu edhe shumën në monedhën vendëse, kursin e këmbimit dhe informacionin në datën kur shuma është kredituar.

7.4 Raporti përfshin, gjithashtu, informacione mbi shpenzimet totale, të ndara në përputhje me titujt e buxhetit të dakorduar, për periudhën raportuese, si dhe shumën e grumbulluar për të gjithë periudhën e Programit.

8. Raportimi përshkrues

8.1 Përfituesi, i dorëzon Suedisë me shkrim një raport fillestar jo më vonë se 6 muaj pas fillimit të aktiviteteve.

8.2 Përfituesi, përmes MTM-së, i siguron Suedisë me shkrim një raport përshkrues çdo gjysmë viti jo më vonë se 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti.

8.3 Raporti narrativ duhet të përmbajë një analizë të progresit të aktiviteteve të projektit dhe rezultateve të pritura, duke ndjekur strukturën e Dokumentit të Programit (korniza e rezultateve siç është shtjelluar më tej në planet gjysmëvjetore të punës).



8.4 Raporti gjysmëvjetor mbulon periudhat nga 1 janari deri më 30 qershor dhe 1 korrik deri më 31 dhjetor. Raporti gjysmëvjetor përmban një llogari mbi një bazë kumulative që mbulon të gjithë periudhën e Programit, për:

1. Aktivitetet e kryera gjatë periudhës së raportimit;

2. Rezultatet e arritura krahasuar me rezultatet e planifikuara;

3. Objektivat e arritur të rezultateve krahasuar me objektivat e rezultateve të planifikuara ose progresin drejt arritjes së objektivave të rezultateve dhe një vlerësim të gjasave të arritjes së objektivave të planifikuar të rezultateve;

4. Një vlerësim të faktorëve të riskut që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave, dhe

5. Një vlerësim të përshtatjeve të mundshme në zbatimin e Programit, duke përfshirë menaxhimin e rrezikut.

8.5 Përfituesi, përmes MTM-së, i paraqet Suedisë me shkrim, jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të periudhës së aktivitetit, një raport përfundimtar. Raporti përfundimtar duhet të përmbajë një llogari mbi një bazë kumulative që mbulon të gjithë periudhën e aktivitetit, për:

1. Rezultatet e arritura krahasuar me rezultatet e planifikuara;

2. Objektivat e arritur të rezultateve krahasuar me objektivat e rezultateve të planifikuara;

3. Një vlerësim të faktorëve që kanë ndikuar në arritjen e objektivave;

4. Mësimet e nxjerra nga implementimi i Projektit; dhe

5. Një vlerësim i nevojave të mundshme për përshtatje në një fazë të re të mundshme të Programit, duke përfshirë veprimet e zbutjes së riskut.

8.6 Përfituesi, përmes MTM-së, i siguron të gjitha ato informacione që lidhen me zbatimin e Programit, siç mund të kërkojnë nga Suedia.

9. Prokurimi

9.1 Përfituesi prokuron të gjithë artikujt e kërkuar për Projektin dhe në përputhje me udhëzimet e PRAG, “Prokurimi dhe grandet për veprimet e jashtme të Bashkimit Evropian - Një udhëzues praktik” - e zbatueshme që nga 15 korriku 2019”. Hapat e mëposhtëm të procedurave të prokurimit dhe të masave të zbatimit kërkojnë miratimin paraprak nga Suedia:

- Kushtet e referencës dhe specifikimet teknike për të gjitha aktivitetet e Projektit;

- Raporti i vlerësimit duke përfshirë pjesët teknike dhe financiare; dhe

- Çdo shtesë e kontratës e cila rrit vlerën e kontratës.

Manuali Operacional përshkruan në detaje rregullimet e prokurimit dhe përgjegjësitë e Suedisë, MTM-së dhe MFE-së.

9.2 Përfituesi, sipas kërkesës, i siguron Suedisë dokumentet/informacionet përkatëse mbi praktikën e saj të prokurimit, vendimet dhe veprimet e ndërmarra, përfshirë detajet dhe kopjet e kontratave që ata kanë dhënë.

10. Monitorimi

10.1 Përfituesi, përmes MTM-së, është përgjegjës për monitorimin e progresit dhe performancës së Programit dhe arritjen e rezultateve të tij të pritshme.

10.2 Suedia monitoron pajtueshmërinë dhe performancën bazuar në këtë Marrëveshje.

10.3 Procesi i rishikimit të progresit të zbatimit të Programit harmonizohet me procesin e rishikimit të Përfituesit.

10.4 Përfituesi, përmes MTM-së, dhe Suedisë mban një dialog të ngushtë, në lidhje me mbështetjen dhe zbatimin e Programit.

11. Konsultimet dhe takimet vlerësuese

11.1 Palët bashkëpunojnë dhe komunikojnë rregullisht me njëra-tjetrën për të gjitha çështjet që lidhen me zbatimin e Programit dhe kësaj Marrëveshjeje.

11.2 Palët takohen çdo 6 muaj për të diskutuar zbatimin e Programit. Takimet thirren dhe drejtohen nga MTM-ja.

11.3 Kostoja e takimeve do të përballohet nga buxheti i Programit.

11.4 Temat kryesore që do të diskutohen gjatë konsultimeve përfshijnë:

a) Rezultatet/progresi i arritur, përfshirë zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve shqiptare;

b) Plani i punës për periudhën pasuese;

c) Çdo kërkesë për ndryshime në termat e referencës ose kontratë;

ç) Veprimet e ndërmarra për të koordinuar zbatimin e projektit me aktivitete të tjera përkatëse (p.sh. aktivitete të tjera të mbështetura nga donatorët);



d) Vendimet e marra;

e) Integrimi i barazisë gjinore dhe çështje të tjera të integritetit.

ë) Pjesëmarrja dhe konsultimi me aktorët lokalë të interesuar, si komunat, kompanitë e shërbimeve publike dhe OSHC-të.

11.5 Rezultati i takimit regjistrohet në procesverbalin e miratuar. Procesverbalet e miratuara hartohen nga MTM-ja dhe një projekt i paraqitet Suedisë, për miratim dhe komente, brenda dy javësh pas takimit. Suedia informon Përfituesin për miratimin dhe komentet e saj brenda 10 ditëve nga marrja e projektit.

11.6 Takimet shitesë të konsultimit mund të kërkohen nga Përfituesi, përmes MTM-së ose Suedisë për çdo temë që ka të bëjë me zbatimin e Programit.

11.7 Përfituesi, përmes MTM-së, informon menjëherë Suedinë për çdo rrethanë që mund të ndërhyjë ose kërcënojë të ndërhyjë në zbatimin e suksesshëm të Programit dhe të ndryshimeve të tjera, me qëllim të zgjidhjes së çështjes, thërret një takim për të informuar dhe konsultuar me Suedinë për çdo veprim korrigjues që duhet të ndërmerret, sipas rastit.

12. Vlerësimet

12.1 Nëse Suedia kryen një vlerësim shitesë, të ndërmjetëm ose *ex post* ose një mision monitorimi, Përfituesi, përmes MTM-së, merr përsipër të sigurojë çdo dokument ose informacion që ndihmon në misionin e vlerësimit ose monitorimit dhe të japë të drejtat e hyrjes siç përshkruhet në këtë Marrëveshje.

12.2 Nëse një Palë kryen ose komisionon një vlerësim gjatë Programit, ajo duhet të informojë Palën tjetër paraprakisht dhe t'i sigurojë Palës tjetër një kopje të raportit të vlerësimit.

12.3 Kostoja e një vlerësimi të kërkuar ose porositur nga Suedia përballohet nga Suedia.

13 Auditimet

13.1 Auditimet e jashtme paguhen nga Programi dhe do të kryhen nga një auditor i jashtëm i pavarur dhe i kualifikuar, i përzgjedhur nga SIDA. Auditimi kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të lëshuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) ose Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) ose në përputhje me standardet e krahasueshme kombëtare.

13.2 Përfituesi, përmes DPFK-së, i paraqet Suedisë një kopje të raportit të auditimit dhe letrën e menaxhimit, siç paraqitet nga firma e auditimit.

13.3 Kushtet Standarde të Referencës të SIDA-s për auditimin financiar, aneksi C, përdoren si referencë dhe kushtet e referencës aprovohen nga Suedia. Raporti i auditimit, duke përfshirë letrën e menaxhimit, dorëzohet në Suedi jo më vonë se 31 mars çdo vit.

13.4 Nëse auditimi përmban një rekomandim, Përfituesi, përmes DPFK-së, i siguron Suedisë brenda tri javësh, me një përgjigje të menaxhimit, duke përfshirë një plan veprimi.

13.5 Suedia në çdo kohë mund të komisionojë ose të kërkojë një kontroll shitesë (të tillë si prokurimi ose kontrolli mjekoligjor), verifikim ose studime financiare. Përfituesi, përmes MTM-së, bashkëpunon dhe ndihmon Suedinë në çdo auditim të tillë.

Kostot për kontrollet shitesë financohen nga Suedia.

14. Shlyerja e interesit, fitimet nga këmbimi dhe fondet e papërdorura

14.1 Në fund të periudhës së aktivitetit, të gjitha fondet e papërdorura që janë më shumë se 500 SEK do t'i kthehen SIDA-s sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se brenda 45 ditëve kalendarike nga momenti i lëshimit nga SIDA të njoftimit të shlyerjes për Përfituesin. Shlyerja përfshin të ardhurat nga interes, fitimet e këmbimit dhe fitimet e tjera financiare të grumbulluara në Grand, përveç nëse është rënë dakord ndryshe.

14.2 Përfituesi, përmes DPFK-së dhe MTM-së, është përgjegjës për të siguruar që çdo fond i dërguar te partnerët zbatues që mbetet i papërdorur në fund të periudhës së aktivitetit t'i kthehet SIDA-s.

14.3 Shlyerjet bëhen në llogarinë bankare të caktuar të SIDA-s për shlyerjet, detajet e së cilës do të sigurohen nga SIDA sipas kërkesës.

14.4 Transaksioni duhet të shënohet qartë: "Fonde të papërdorura". Emri i Përfituesit përcaktohet së bashku me numrin e kontributit të SIDA-s dhe titullin e marrëveshjes.

15. Korrupsioni dhe parregullsia të tjera

15.1 Palët punojnë në mënyrë aktive për të parandaluar korrupsionin dhe parregullsitë e tjera brenda Projektit. Ky detyrim vlen për të gjithë anëtarët e personelit, këshilltarët dhe personelin tjetër jo të përhershëm.



15.2 Korrupsioni dhe parregullsitë e tjera u referohen të gjitha llojeve, të:

a) korrupsionit, përfshirë ryshfetin, nepotizmin, përfitimet e paligjshme ose një formë tjetër e abuzimit të besimit, pushtetit dhe pozitës për përfitime të papërshtatshme;

b) keqpërdorimit të parave në dorë, inventarit dhe të gjitha llojeve të tjera të aseteve;

c) deklaratave mbi mashtrimet financiare dhe jofinanciare;

d) e gjitha përdorimeve të tjera të fondeve që nuk është në përputhje me planin e punës dhe Buxhetin.

15.3 Palët:

a) marrin parasysh rrezikun e korrupsionit dhe parregullsitë e tjera kur planifikojnë dhe zbatojnë Programin dhe identifikojnë rreziqet kryesore dhe masat e zbutjes së rreziqeve. Nëse identifikohet një rrezik potencial i korrupsionit dhe i parregullsive të tjera, miratohen masat e zbutjes së riskut për të zvogëluar rrezikun e identifikuar;

b) organizojnë operacionet e tyre dhe sistemet e kontrollit të brendshëm në një mënyrë që korrupsioni dhe parregullsitë e tjera të parandalohen, menaxhohen dhe zbulohen;

c) bëjnë çmos për të parandaluar dhe ndaluar korrupsionin dhe parregullsitë e tjera brenda Programit;

d) kërkojnë që i gjithë personeli i përfshirë në të, dhe çdo këshilltar, furnizues dhe kontraktues i financuar nga Programi të heqin dorë nga korrupsioni dhe parregullsitë e tjera.

15.4 Përfituesi informon SIDA-n përmes DPFK-së dhe MTM-së menjëherë për çdo tregues korrupsioni dhe parregullsish të tjera në lidhje me Programin.

15.5 Përfituesi merr përsipër, përmes DPFK-së dhe MTM-së, të hetojë praninë e korrupsionit dhe parregullsive të tjera dhe të ndërmarrë veprime, duke përfshirë veprime ligjore, kundër personave që ka arsye për të dyshuar për korrupsion dhe parregullsi të tjera. Palët vazhdimisht konsultohen me njëra-tjetrën për trajtimin e mëtejshëm të çështjes.

16 Mjetet mbrojtëse

16.1 Në rast të mosrespektimit nga Përfituesi të dispozitave të kësaj Marrëveshje, Suedia rezervon të drejtën për të ushtruar mjetet juridike të mëposhtme, duke përfshirë mbajtjen në burim të disbursimeve të mëtejshme dhe/ose uljen e

disbursimeve të reja, duke kërkuar shlyerjen e fondeve ose ndërprerjen e mbështetjes së saj për Programin.

16.2 Në rast të shkeljes së Marrëveshjes, Suedia mund ta prishë Marrëveshjen me një njoftim prej dy muajsh.

16.3 Në rast të shkeljes serioze të Marrëveshjes, Suedia mund ta prishë Marrëveshjen me efekt të menjëhershëm.

16.4 Në rast të prishjes nga Suedia, kjo nuk do të zbatohet për fondet e kryera në mënyrë të pakthyeshme me mirëbesim nga Përfituesi ndaj palëve të treta përpara datës së njoftimit të prishjes, me kusht që zotimet të jenë bërë në përputhje me këtë Marrëveshje.

16.5 Çdo përfundim i njëanshëm i marrëveshjes bëhet me njoftim me shkrim nga palët.

17. Vizibiliteti dhe informacioni

17.1 Kur u referohemi aktiviteteve të financuara plotësisht ose pjesërisht, në përputhje me këtë Marrëveshje, Përfituesi, përmes MTM-së, gjithmonë njuh dhe bën publike që aktivitetet po financohen përmes ndihmës suedeze për zhvillim.

17.2 Tipi i logos së Suedisë përdoret në prodhimin e materialeve të informacionit dhe në lidhje me aktivitetet e informacionit.

17.3 Prodhimi i materialeve të tilla është plotësisht përgjegjësi e Përfituesit dhe përgjegjësia e përmbajtjes i takon botuesit. “SIDA” ose “Suedia” nuk mund të përdoren në mënyrë të tillë që të mund të perceptohet sikur SIDA ose Suedia ka marrë pjesë në prodhimin ose mbështetjen e ndonjë mendimi të paraqitur.

17.4 SIDA dhe departamentet e tjera të administratës suedeze jashtë vendit rezervojnë të drejtën për të kopjuar dhe shpërndarë materiale të tilla nëse kërkohet.

18. Referenca te marrëveshjet e tjera

Bashkëpunimi midis Palëve sipas kësaj Marrëveshjeje rregullohet, gjithashtu, nga:

18.1 Marrëveshja mbi termat dhe kushtet e përgjithshme për bashkëpunim zhvillimor midis Palëve për periudhën 30 qershor 2006 deri në përfundimin nga secila palë me njoftim me shkrim prej 6 muajsh;

18.2 Marrëveshja për Bashkëpunimin e Zhvillimit ndërmjet palëve për periudhën 9 shkurt 2016–31 dhjetor 2020; dhe

18.3 Çdo marrëveshje që mund të zëvendësojë ose ndryshojë marrëveshjet në fjalë.



19. Pushimi i fuqisë

19.1 Kjo Marrëveshje mbetet e vlefshme deri në 42 muaj pas hyrjes në fuqi, përveç nëse përfundohet më parë me njoftim me shkrim me afat gjashtë mujor nga secila Palë.

19.2 Në rast të prishjes nga Përfituesi, asnjë fond nuk vihet në dispozicion për aktivitete pas gjashtë muajsh pas momentit të njoftimit me shkrim.

19.3 Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Palëve, në përputhje me këtë Marrëveshje mbeten të paprekura deri në kthimin e fondeve të mbetura/bilancit të fondit në Suedi dhe përmbushjen e kërkesave të raportimit të kësaj Marrëveshjeje, kohë në të cilën kjo Marrëveshje përfundon.

20. Periudha e vlefshmërisë së Marrëveshjes

20.1 Marrëveshja hyn në fuqi pas komunikimit me shkrim të Përfituesit për përfundimin e procedurave të saj të brendshme dhe mbetet e vlefshme deri në 42 muaj pas hyrjes në fuqi të saj, përveç nëse ajo përfundon në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje ose deri në kthimin e fondeve të papërdorur për SIDA-n dhe përmbushjen e kërkesave për raportim të kësaj Marrëveshjeje, kohë në të cilën kjo Marrëveshje përfundon.

20.2 Përfundimi ose mbarimi i Marrëveshjes nuk i liron Palët nga asnjë përgjegjësi që rrjedh nga ndonjë veprim ose mosveprim që ka ndodhur para këtij përfundimi ose mbarimi.

21. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Nëse lind një mosmarrëveshje midis nënshkruesve, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, ata konsultohen me njëri-tjetrin në mënyrë që të arrihet një zgjidhje miqësore.

22. Njoftimet

Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të jetë me shkrim, duke treguar numrin e kontributit të SIDA-s dhe titullin e Projektit dhe të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për Suedinë:

Ambasada e Suedisë në Tiranë, rruga “Pjetër Budi” 56, Tiranë

Në vëmendje të Tomas Nystrom

Për Përfituesin:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë

Kjo Marrëveshje është nënshkruar në gjuhën shqipe dhe angleze, në katër origjinale, dy për secilin Nënshkrues.

Tiranë, 4.6.2021

Tiranë, 1.6.2021

Vendi dhe data
Këshilli i Ministrave i
Republikës së Shqipërisë, i
përfaqësuar nga Ministria
e Financave dhe
Ekonomisë

Vendi dhe data
Agjencia Suedeze për
Bashkëpunim dhe
Zhvillim Ndërkombëtar
(për Suedinë)

Nënshkrimi
MINISTRI ANILA
DENAJ

Nënshkrimi
AMBASADORI ELSA
HÅSTAD

VENDIM

Nr. 418, datë 8.7.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 953, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR. 92/2014, ‘PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 10, “Përcaktimi i kategorisë së eksportuesve për qëllim të rimbursimit të TVSH-së”, në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 10

Përcaktimi i kategorisë së eksportuesve për qëllim të rimbursimit të TVSH-së

1. Në zbatim të pikës 3, të nenit 77, të ligjit, kërkesat për rimbursimin e TVSH-së të bëra nga personat e tatueshëm eksportues dhe personat e tatueshëm që riekportojnë mallrat joshqiptare nën regjimin e përpunimit aktiv në Republikën e



Shqipërisë, siç përcaktohet në Kodin Doganor, ndahen sipas kategorive të parashikuara në këtë nen.

2. Rimbursohen automatikisht, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes, kërkesat për rimbursim të TVSH-së, të vlerësuara si kërkesa të bëra nga personat e tatueshëm të përmendur në pikën 1, të këtij neni, me risk zero, të cilët plotësojnë njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

- a) kanë status të aktivitetit “aktiv”;
- b) vlera e eksporteve të kryera në periudhën/at tatimore, për të cilën/at kërkohet rimbursim, është më shumë se 70 (shtatëdhjetë) % e vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, e verifikuar edhe nga raportet doganore të eksporteve në sistem;
- c) kanë aktivitet eksportues mbi 1 (një) vit;
- ç) nuk kanë detyrime të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

3. Kërkesat e personave të tatueshëm, vlera e eksporteve të të cilëve, të kryera në periudhën/at tatimore për të cilën/at kërkohet rimbursimi, përbën më shumë se 50 (pesëdhjetë) % deri në 70 (shtatëdhjetë) % të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, rimbursohen brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së, duke iu nënshtruar më parë procedurës së analizës së riskut. Në këtë kategori bëjnë pjesë edhe kërkesat e personave të tatueshëm, vlera e eksporteve të të cilëve është mbi 70 (shtatëdhjetë) %, por që nuk plotësojnë njëkohësisht kriteret e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni.

Nëse nga analiza e riskut rezulton se personi i tatueshëm që klasifikohet në këtë kategori duhet t'i nënshtrohet procesit të kontrollit tatimor, e gjithë procedura, përfshirë kontrollin, përfundon brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Edhe nëse nuk ka përfunduar në afat procedura e kontrollit, brenda afatit 30-ditor nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim, kryhet rimbursimi i TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit, me përjashtim të kërkesave të personave të tatueshëm që rezultojnë me status të aktivitetit “pasiv”, të cilët detyrimisht do të rimbursohen pas përfundimit të procedurës së kontrollit tatimor.

4. Të gjithë personat e tjerë të tatueshëm që kryejnë eksporte, por që nuk klasifikohen në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, rimbursohen brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim, duke iu nënshtruar procedurës së analizës së riskut.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Nr. 10, datë 2.6.2021

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”, në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘sekret shtetëror’”, kreu II, neni 4, pika “a”, “c”, dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017, për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr. 13, datë 3.5.2018 të kryetarit të Autoritetit, “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘sekret shtetëror’”, të ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 10, datë 2.6.2021, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Procesverbal nr. 62/5 prot., datë 15.2.1989, mbi dorëzimin e materialeve operative të ndjekjes së krimeve të Rajonit të Policisë nr. 8, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit është “A. Rez. Personal”.

2. Urdhër i Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 292/1 prot., datë 14.10.1986, “Mbi dërgimin e urdhrit të ministrit të Punëve të Brendshme për shpërndarjen e direktivës mbi funksionet dhe detyrat e Forcave të Ministrisë së Punëve të Brendshme për kohë lufte”, me 7



(shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Sekret i Rëndësisë Veçantë”.

3. Vendim i shefit të policisë së rrethit “Për heqjen nga përpunimi paraprak të Violeta Mullarajt dhe veçimin e dosjes për asgjësim”, me 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit është “Sekret”.

4. Libër i dorëzimit të dokumenteve nr. 24, me 99 (nëntëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. Dokumenti daton në vitet 1987 – 28.6.1991.

5. Dosje nr. 18, relacion mbi keqinterpretimet dhe shtrembërime në urdhrin e kryeministrit, që bën fjalë për spastrimin e aparatit shtetëror nga elemente të padëshirueshme me 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

6. Dosje nr. 17, relacion drejtuar udhëheqjes së Partisë së Shtetit mbi vërtetimin e shifrave mbi gjendjen aktuale dhe industriale të Shqipërisë, me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

7. Dosje nr. 16, relacion dërguar kryetarit të Këshillit të Ministrave mbi krimet e kryera në sektorin e ekonomisë socialiste gjatë vitit 1955 me 25 (njëzet e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

8. Dosje nr. 15, relacion mbi masat e organeve të Sigurimit të Shtetit në lidhje me disa probleme ekonomike të rëndësishme, me 2 (dy) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

9. Dosje nr. 21, relacion drejtuar udhëheqjes së Partisë mbi qëndrimin armiqësor të specialistëve të huaj polak, hungarez në vendin tonë, me 5 (pesë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

10. Dosje nr. 113, inventari i dosjes dhe informacione dërguar udhëheqjes së partisë e Shtetit mbi disa të meta e mangësi në sektorin e industrisë së naftës, me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1974. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

11. Dosje nr. 114, inventari i brendshëm i dosjes, informacione dërguar udhëheqjes së Partisë e Shtetit mbi dëmtimet e vjedhjet e pasurisë socialiste, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1974. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

12. Dosje nr. 110/2, raport mbi karakteristikat kryesore të veprimtarisë armiqësore e keqbërëse në

drejtim të ekonomisë gjatë vitit 1973, rezultatet e organeve kundër kësaj veprimtarie dhe detyrat për vitin 1974, me 37 (tridhjetë e shtatë) fletë. Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1973. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

13. Dosje nr. 110/3, informacione mbi rolin dhe detyrat e agjencurës së profilizuar për zbulimin dhe parandalimin e veprimtarisë armiqësore e keqbërëse në drejtim të ekonomisë, me 22 (njëzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

14. Dosje nr. 100/1, inventari i brendshëm i dosjes, informacione mbi zbatimin e detyrave për mbrojtjen e ekonomisë socialiste, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1968. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

15. Dosje nr. 100, relacion mbi kriteret e hetuesisë në sektorin ekonomik të uzinave mekanike, me 1 (një) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1965. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

16. Dosje nr. 91, raport vjetor mbi veprimtarinë armiqësore të elementit armik në sektorin ekonomik dhe pasqyrat statistikore mbi krimet në ekonomi, përpunimet dhe agjencura, me 28 (njëzet e tetë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1963–1964. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

17. Dosje nr. 55, pasqyra statistikore e përpunimeve 2-A dhe 2-B të agjencurës dhe të arrestimeve, me 6 (gjashtë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

18. Dosje nr. 49, pasqyra statistikore e përpunimeve 2-A dhe 2-B, si dhe pasqyrë e agjencurës dhe pasqyrë statistikore e arrestimeve, me 10 (dhjetë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

19. Dosje nr. 98, urdhri i ministrit të Punëve të Brendshme mbi shpërblimin nga fondi i veçantë të Hysen Shehut dhe relacion mbi këtë problem, me 4 (katër) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1970. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

20. Dosje nr. 96/1, analizë mbi punën e kartotekës, si dhe informacion mbi evidencën operative të kontingjenteve armike të shtetit, me 20 (njëzet) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në



vitet 1969. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

21. Dosje nr. 96/2, akt kontroll dhe informacion mbi kontrollin e llogarisë së fondit të veçantë në Drejtorinë e Zbulimit, me 9 (nëntë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1969. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

22. Dosje nr. 93/1, informacion mbi gjendjen e Arkivit dhe masat që propozohet për përmirësimin e kushteve të tij, me 4 (katër) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1968. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

23. Dosje nr. 85/2, regjistër emëror i agjunkturës të sektorëve operativë të policisë popullore për periudhën 1952–1965, me 80 (tetëdhjetë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1965. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

24. Dosje nr. 85/1, regjistër emëror i personave në përpunim për llogari të sektorit operativ të policisë; me 77 (shtatëdhjetë e shtatë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1965. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

25. Dosje nr. 76, statistika vjetore mbi agjunkturën, përpunimet 2-A dhe 2-B, me 8 (tetë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1961. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

26. Dosje nr. 75, statistika vjetore mbi agjunkturën, përpunimet 2-A dhe 2-B dhe relacion analitik mbi statistikat, me 14 (katërmëdhjetë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1960. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

27. Dosje nr. 68, statistika mbi agjunkturën, përpunimet 2-A dhe 2-B dhe arrestimet, me 7 (shtatë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1958. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

28. Dosje nr. 108/5, vlerësime të Komisionit të Ekspertizës për asgjësim dokumentesh, me 31 (tridhjetë e një) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1971. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

29. Dosje nr. 102/2, vlerësime të Komisionit të Ekspertizës për asgjësim dokumentesh, me 33 (tridhjetë e tre) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1965–1970. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

30. Dosje nr. 108/4, informacion mbi një të burgosur, Muharrem Kaloshi, dhe disa dobësi në drejtim të kontroll-rezervimit, me 5 (pesë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1971. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

31. Dosje nr. 12, informacione mbi gjendjen ekonomike në Greqi, me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1954. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

32. Dosje nr. 51, listë dhe fotografi të bandës dhe të thyesave të kufirit, me 3 (tri) fletë dhe 15 foto në zarf. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1960. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

33. Dosje nr. 94, relacion mbi disa shkelje të rënda nga punonjës të organeve të kundërzbulimit, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1974. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

34. Dosje nr. 92, informacione mbi tërheqjen në bashkëpunim të kandidatëve ushtarë, mbi goditjen e grupit “Kënetë”, mbi disa ngjarje negative në doganën e Morinës, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1973. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

35. Dosje nr. 43, relacione mbi personat që implikohen në procesin e të pandehurve L. G., P. B., D. N. etj., me 73 (shtatëdhjetë e tre) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

36. Dosje nr. 86, relacione të Ministrisë dërguar Komitetit Qendror të Partisë mbi veprimtarinë armiqësore të elementit antiparti dhe personat që implikohen si D. N., L. G. etj., me 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

KRYETAR I KOMISIONIT TË
DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT
Gentiana Sula



BIBLIOGRAFI
Nr. 11, datë 4.6.2021

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË
DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”, në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, kreu II, neni 4, pika “a”, “c”, dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017, ‘Për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr. 13, datë 3.5.2018, të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të

Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, i ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 11, datë 4.6.2021, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. **Fashikull verifikimi nr. 323**, në ngarkim të **A.H.**, me 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

2. **Dosje pune dhe personale nr. 12611**, në ngarkim të **S.B.**, me 37 (tridhjetë e shtatë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

KRYETAR I KOMISIONIT TË
DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT
Gentiana Sula

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë